



Republika e Kosovës
Republika Kosova-Republic of Kosovo
Qeveria - Vlada - Government
Zyra e Kryeministrit -Ured Premijera -Office of the Prime Minister
Agjencia e Statistikave të Kosovës - Agencija za Statistike Kosova - Kosovo Agency of Statistics

Agjencia e Statistikave të Kosovës

Plani Vjetor i Statistikave Zyrtare 2018

PËRMBAJTJA

Faqe

1. PËRMBLEDHJA E OBJEKTIVAVE.....	4
2. STRUKTURA E PVSZ 2018.....	6
3. PRODHIMI.....	7
4. VLERËSIMI I PERFORMANCËS.....	8
4.1 PRODUKTIVITETI DHE EFIKASITETI.....	10
4.2 PRODHIMI.....	15
4.3 CILËSIA.....	16
4.4 KORNIZA E PLANIFIKIMIT.....	17
4.4.1 INSTRUMENTËT E PLANIFIKIMIT.....	18
Në vitin 2016, ASK-ja :.....	19
4.4.2 RIORGANIZIMI.....	20
4.5 STANDARDET E BE-SË PËR CILËSINË.....	21
4.6 KËNAQSHMËRIA E PËRDORUESVE.....	21
4.7 PËRMBLEDHJA E VLERËSIMIT TË PERFORMANCËS.....	22
5. PRIORITETET STRATEGJIKE.....	23
PRIORITETI 4.VLERËSIMI I SISTEMIT STATISTIKOR TË KOSOVËS.....	24
5.1 ZHVILLIMI I STATISTIKAVE EKONOMIKE.....	24
5.2 FUSHAT E TJERA STATISTIKORE DHE NDËRLIDHJET E TYRE.....	25
5.3 TABELA PËRMBLEDHËSE E ZHVILLIMIT ORGANIZATIV MË 2018.....	26
5.4 TABELA PËRMBLEDHËSE NË ZHVILLIMIN E FUSHAVE STATISTIKORE NË VITIN 2018.....	28
5.4.1 PËRPUNIMI I STATISTIKAVE TË VEÇANTA.....	33
6. PLANI I VEPRIMIT VJETOR 2018.....	34
6.1 BUXHETI.....	34
6.2 PASQYRA E PRODHIMIT.....	34
6.3 PLANI I AKTIVITETEVE.....	44
6.3.1 BRUTO PRODUKTI VENDOR (BPV).....	44
6.3.2 STATISTIKAT E BIZNESIT.....	45
6.3.3 ÇMIMET.....	46
6.3.4 STATISTIKAT E TREGTISË SË JASHTME.....	47
6.3.5 ANKETA E EKONOMIVE BUJQËSORE - ANKETA E KULTURAVE BUJQËSORE BIMORE EDHE E BLEGTORISË.....	48
6.3.7 STATISTIKAT AGRONOMETARE.....	48
6.3.8 STATISTIKAT E MJEDISIT - ANKETA E MBETURINAVE KOMUNALE.....	49
6.3.9 STATISTIKAT E MJEDISIT - ANKETA E MBETURINAVE INDUSTRIALE.....	49
6.3.10 STATISTIKAT E MJEDISIT - ANKETA E MBETURINAVE TË TRAJTUARA.....	49
6.3.11 FAKTË MBI MJEDISIN.....	49
6.3.12 STATISTIKAT E UJËRAVE NË KOSOVË.....	50
6.3.14 REGJISTRIMI I BUJQËSISË.....	50
6.3.13 STATISTIKAT E TJERA PËR EKONOMI FAMILJARE DHE INDIVIDË.....	50
6.3.14 ANKETA E FUQISË PUNËTORE (AFP).....	51
6.3.15 ANKETA MBI TË ARDHURAT DHE KUSHTE TË JETESËS (AAKJ) (ANG. SILC).....	51
6.3.16 VJETARI STATISTIKOR I REPUBLIKËS SË KOSOVËS 2018.....	52
7. DPPKK - PLANI I PUNËS.....	53
8. DRA -DEPARTAMENTI I REGJISTRIMIT DHE ANKETIMIT.....	56
9. DEPARTAMENTI I ADMINISTRATËS.....	57

LISTA E SHKURTESAVE

AAKJ	Anketa mbi të Ardhurat dhe Kushtët të Jetesës
ABEF	Anketa e Buxhetit të Ekonomive Familjare
AFP	Anketa e Fuqisë Punëtore
TIK	Teknologjia e informacionit dhe Komunikimit
ASB	Anketa Strukturore e Biznesit
ASK	Agjencia e Statistikave të Kosovës
SASh	Statistikat Afat-Shkurta
BB	Banka Botërore
BE	Bashkimi Evropian
BiP	Bilanci i Pagesave
BPV	Bruto Produkti Vendor
BQK	Banka Qendrore e Kosovës
DA	Departamenti i Administratës
DSBM	Departamenti i Statistikave të Bujqësisë dhe Ambientit
DSELLK	Departamenti i Statistikave Ekonomike dhe Llogarive Kombëtare
DMTI	Departamenti i Metodologjisë dhe TI-së
DPPKK	Departamenti i Politikave, Planifikimit, Komunikimit dhe Koordinimit
DRA	Departamenti i Anketimeve dhe Regjistrimeve
DSS	Departamenti i Statistikave Sociale
SMIA	Sistemi Informativ për Menaxhimin e Arsimit
SE	EUROSTAT
SELI	Sistemi Evropian i Llogarive
SES	Sistemi Evropian i Statistikave
FTË	Fondacioni për Trajnime Evropiane
FMN	Fondi Monetar Ndërkombëtar
GIS	Sistemi Gjeografik i Kosovës
IÇIMP	Indeksi i Çmimeve të Importit
IÇK	Indeksi i Çmimeve të Konsumit
IÇP	Indeksi i Çmimeve të Prodhimit
IKN	Indeksi i Kostos së Ndërtimit
IPA	Instrumenti i Para-Aderimit
LIEB	Llogaritë Ekonomike për Bujqësi
LLK	Llogaritë Kombëtare
KB	Kombet e Bashkuara
KVP	Korniza e Vlerësimit të Performancës
MeM	Memorandum Mirëkuptimi
KASh	Korniza e Shpenzimeve Afat-Mesme
NACE	Nomenklatura e Aktiviteteve në Komunitëtin Evropian
PIN	Statistika në Pozitën e Investimeve Ndërkombëtare
PKSZ	Programi Kryesor i Statistikave Zyrtare
PLAN	Departamenti për Politika, Planifikim, Koordinim dhe Komunikim
PSZ	Programi i Statistikave Zyrtare
PVSZ	Plani Vjetor i Statistikave Zyrtare
PZSZ	Programi i Zgjeruar i Statistikave Zyrtare
SCB	Statistikat e Suedisë
Sida	Agjencia Suedeze për Bashkëpunim dhe Zhvillim Ndërkombëtar

SLLK	Sistemi i Llogarive Kombëtare
TFSH	Tabelat e Furnizimit dhe Shfrytëzimit
AT	Asistencë Teknike
TI	Teknologjia Informative
TIMD	Departamenti i Teknologjisë Informative, Metodologjisë dhe Diseminim/Shpërndarjes
UNDP	Programi Zhvillimor i Kombeve të Bashkuara
UNFPA	Fondi për Popullsi i Kombeve të Bashkuara
UNICEF	Fondi për Fëmijë i Kombeve të Bashkuara
OE	Operatori ekonomik
TIK	Teknologjia informative e komunikimit
ILO-	Organizata Ndërkombëtare e Punës

1. PËRMBLEDHJA E OBJEKTIVAVE

Plani vjetor i punës së ASK-së është planifikim për zbatimin e prioriteteve në bazë të resurseve njerëzore dhe financiare në dispozicion. Qëllimi i ASK-së, është prodhimi i Statistikave zyrtare në përputhje me metodologjinë ndërkombetare (Eurostat) duke ofruar statistika cilësore, relevante, të besueshme, në kohë dhe të sakta, që i përmbushin nevojat e të gjithë shfrytëzuesve vendorë dhe ndërkombëtarë në aspektin e vendimmarrjes bazuar në fakte dhe të dhëna statistikore. Plani Vjetor i Punës për vitin 2018 përgaditet në përputhje me Ligjin për Statistika Zyrtare i cili përfshin kërkesat e shfrytëzuesve duke i transformuar në objektiva afatshkurtëra. Po ashtu në plan janë të përfshira kërkesat nga dokumente tjera vendore afatgjata si PKZMSA, ERA, PVPQ, etj. Plani dërgohet në qeveri për aprovim në përputhje me afatin kohor sipas Ligjit. Plani vjetor është instrument përmes të cilit bëhet i mundur implementimi i objektivave të caktuara në programin afatmesëm të statistikave zyrtare (2018-2022). Programi pritet të hartohet deri në fund të vitit 2017, i cili do të shërbejë si udhërrëfyes në periudhën e ardhshme pesë vjeçare. Përmes Planit Vjetor 2018, synohet realizimi i objektivave, që kanë për qëllim shfrytëzimin më të mirë të burimeve përmes efikasitetit organizativ. Në këtë kontekst, Plani Vjetor i Statistikave Zyrtare përcakton prioritetet operative nga Programi i Statistive Zyrtare (PSZ), Programi Kombëtar për zbatimin e Marrëveshjes së Stabilizim Asocimit (PKZMSA-së), si dhe dokumenteve të tjera strategjike kombëtare dhe ndërkombëtare, me qëllim të përmbushjes së nevojave me të dhëna statistikore. Përcaktimi i prioriteteve bëhet duke synuar të arrihet efikasitet, produktivitet, rritje cilësore në sistemin statistikor, përmbushje e kërkesave të shfrytëzuesve dhe standardeve të BE-së.

Plani Vjetor i Statistikave Zyrtare në formën e re ka filluar që nga viti 2013 mbi bazën PSZ 2013-2017. Plani 2018 është plani i parë pas përfundimit të programit të parë 5 vjeçar të statistikave zyrtare 2013-2017. Në këtë kontekst Plani vjetor 2018 do të jetë pjesë përbërëse e Programit të statistikave zyrtare 2018-2022. Shikuar nga perspektiva e planifikimit dhe e monitorimit, për secilin vit brenda këtij programi do të caktohen objektivat përkatëse, bazuar në kërkesat e brendshme dhe ndërkombëtare. Andaj, në këtë drejtim në fund të vitit 2017, do të bëhet një prerje (matje) e të arriturave në programin e parë 5 vjeçar, të vendosura, për herë të parë në vitin 2013. PVSZ 2013¹ kishte vendosur objektivat e veprimit (sektori 7.2), që në masë të konsideruar janë realizuar, përderisa ato që ishin në progres, janë vlerësuar gjatë vitit vijues e kështu me radhe. Në këtë mënyrë, realizimi i objektivave të secilit vit përkatës është analizuar në vitet pasuese, si psh. në vitin 2017 është bërë vlerësimi i objektivave për vitin 2016, dhe mbi këtë bazë, analizat dhe vlerësimet e tilla kanë shërbyer në përgatitjen e planeve vjetore.

ASK-ja gjatë gjithë periudhës 2013-2017 sipas renditjes së prioriteteve përmes planeve vjetore të veprimit ka arritur në masë të madhe përmbushjen e synimeve të cekura në kapitullin përkatës të programit të statistikave zyrtare 2013-2017. Megjithatë vlerësimi (matja e përgjithshme) do të bëhet në fund të vitit 2017 dhe në Programin e dytë 5 vjeçar do të strukturohen qëllimet dhe pa dyshim, pjesë e këtij programi gjatë vitit 2018 (*disa nga këto synime do të vazhdojnë të inkorporohen edhe në programin 2018-2022*) do të jenë synimet si në vijim:

¹Agjencia e Statistikave të Kosovës, Plani Vjetor i Statistikave Zyrtare 2013, 13 maj 2012.

1. Fuqizimi i kapaciteteve administrative
2. Përafrimi i statistikave (me theks të veçantë i statistikave makroekonomike dhe të biznesit) me standardet evropiane
3. Zbatimi i Ligjit të amandamentuar për statistikën zyrtare;
4. Rritja e prodhimit të statistikave zyrtare me theks të veçantë makro-ekonomike, të biznesit, statistikave të energjisë, tregut të punës (LFS), të ardhurat dhe kushtet e jetesës (SILC), teknologjisë dhe komunikimit, etj
5. Rritja e resurseve njerzore dhe financiare duke përfshirë trajnimet, etj
6. Avancimi i i vazhdueshem i kornizës planifikuese të ASK-së, finalizimi i zbatimit të KVP-së, si dhe avancimi i sistemit të SIPK-ut me module të reja;
7. Avancimi i dialogut me përdorues;
8. Avancimi i shpërndarjes së të dhënave në mënyrë elektronike
9. Fuqizimi i teknologjisë Informativ (TI) dhe shërbimeve mbështetëse;
10. Zhvillimi dhe zbatimi i procesit të dokumentimit (metadata) .
11. Zbatimi i Planit të veprimit pas procesit të vlerësimit të sistemit Statistikor nga Eurostat (Peer Review).

Ngasa u tha më lartë PVSZ për vitin 2018, përcakton prioritet për zhvillimin e statistikave sektoriale, *(këto prioritet do të jenë pjesë P5SZ 2018-2022 ose të reviduara).*

Në kuadër të Kornizës së Burimeve Ekzistuese janë:

1. Llogaritë Kombëtare (PKSZ²),
2. Statistikat e Biznesit (PKSZ),
3. Çmimet (PKSZ),
4. Tregtia e Jashtme (PKSZ),
5. Anketa e Ekonomive Bujqësore (PKSZ),
6. Anketa e Mbeturinave Industriale;
7. Anketa e Mbeturinave Komunale;
8. Çmimet dhe Indeksi i Çmimeve në Bujqësi;
9. Llogaritjet Ekonomike në Bujqësi;
10. Vlerësimi Vjetor i Popullsisë (PKSZ),
11. Anketa e Fuqisë Punëtore (AFP),PKSZ,
12. Anketa e Buxhetit të Ekonomive Familjare (ABEF), PKSZ,
13. Te dhënat Vitale (kuartale)
14. Statistikat Gjimore (çdo 2 vite)
15. Të dhënat administrative (PKSZ),
16. Bilanci i Energjisë (PKSZ),
17. Statistikat e Eficiencës së Energjisë,
18. Llogaritë Qeveritare në baza tremujore (TM4 2017 deri TM3 2018).

Jashtë Kornizës së Burimeve Ekzistuese:

1. Publikimet e specializuara/tematike nga baza e Regjistrimit të Bujqësisë 2014,
2. Realizimi i Anketës së Ekonomisë joformale,

² Programi Kryesor i Statistikave Zyrtare (PKSZ) definohet përmes PSZ 2013-2017 me minimumin e kërkesave për prodhimin e statistikave, për t'i mbuluar nevojat bazë për vendimmarrje të Qeverisë. Nevojat e tjera për Statistika, të shprehura nga përdoruesit kombëtarë dhe ndërkombëtarë, si dhe nga Programi Statistikor i BE-së, do të ketë përparësi në Programin e Zgjeruar (PZSZ). Shih në vijim pjesën e pasqyrës së publikimit 3.2.

3. Statistikat e Prodhimit Industrial,
4. Statistikat e Investimeve,
5. Statistikat e Migracionit,
6. Statistikat e Varfërisë
7. Statistikat mbi përdorimin e TIK-ut në ekonomi familjare dhe biznese
8. Statistikat e Kulturave Bujqësore Bimore, Blegtorisë dhe Prodhimeve Blegtorale, si dhe Pylltarisë,
9. Anketa Testuese në Pemëtari
10. Llogaritjet Ekonomike në Bujqësi, në baza tremujore dhe parashikuese,
11. Statistikat e Mjedisit (Anketa e Mbeturinave tëTrajtuar, Statistikat e Ajrit, GHHGE).

Objektivat e lartëcekura janë prioritetet për vitin 2018. Objektivat e listuara jashtë burimeve ekzistuese realizohen në varësi të sigurimit të burimeve të nevojshme buxhetore (njerëzore dhe financiare).

2. STRUKTURA E PVSZ 2018

Qasja e përgjithshme në hartimin e planit të punës mbështetet në filozofinë e vlerësimit të të arriturave respektivisht matjen e performancës në vitin e kaluar, analizën e gjendjes dhe planifikimin e të ardhmes mbështetur në resurset e disponueshme. Andaj ngasa u tha më lartë, përmbajtja e Planit Vjetor 2018 është e përmbledhur në tri shtylla kryesore:

1. Vlerësimin e performancës
2. Prioritetet strategjike, dhe
3. Planin Vjetor të Veprimit.

Të tri shtyllat e lartëpërmendura janë të bazuara në procese argumentuese, sipas Ciklit të Planifikimit.

Në kuadër të vlerësimit të performancës bëhet matja e të arriturave në vitin paraprak duke përfshirë edhe menaxhimin e bazuar në rezultate si dhe ndikimin e këtyre të arriturave në planin vijues.

Në kuadër të prioriteteve strategjike (forcimi i procesit planifikues, riorganizimi i vazhdueshëm në nivel njësie, kalimi nga konsolidimi në zhvillimin e mëtejshëm të procesit prodhues, avancimi i dialogut me shfrytëzues, modernizimin e proceseve prodhuese përmes forcimit të TI-së dhe njësive mbështetëse, zhvillimi dhe përmirësimi i proceseve dokumentuese metodologjike dhe proceseve të prodhimit, avancimi i bashkëpunimit rajonal dhe nërkombëtarë) bëhet analiza e prioriteteve bazuar në vlerësimin e performancës, në formë të veprimeve, për secilin prioritet veç e veç të cilat realizimi apo zbatimi i tyre ka një proces kohor me të gjatë se një vit e madje disa edhe gjatë tërë ciklit të PSZ.

Në kuadër të planit vjetor të veprimit vendosen aktivitetet bazë për periudhen një vjeçare në harmoni me programin pesë vjeçar, duke shfrytëzuar burimet njerëzore dhe financiare në dispozicion.

Zbatimi i KVP-së, është mekanizëm përmes të cilit matet progresi për 8 indikatorët kyç dhe si i tillë ka filluar gjatë vitit 2013 dhe vazhdon të zbatohet në tërësi deri në vitin 2017, me modifikime të mundshme nga departamentet përkatëse. Ndërsa, objektivat e reja të veprimit në kapitujt përkatës do të zhvillohen konform objektivave strategjike të PSZ 2018-2022 .

3. PRODHIMI

Një nga synimet kryesore në Planin vjetor 2018 si dhe PSZ 2018-2022 do të jetë rritja e prodhimeve statistikore, me një normë mesatare 3-4 % në vit. Që nga fillimi i zbatimit të programit të parë të statistikave zyrtare, ASK-ja ka shënuar rritje. Ky trend pozitiv ka vazhduar gjatë tërë periudhës pesë vjeçare, duke arritur në 57 produkte statistikore në fund të vitit 2016 në krahasim me vitin 2012 që kishte me 39 produkte statistikore. Me Planin Vjetor 2017 janë planifikuar të prodhohen produkte shtesë (nga viti 2016) sipas objektivit në dokumentin strategjik PSZ 2013-2017. Ndërsa, për vitin 2018 planifikohën të prodhohen 2 prodhime statistikore shtesë, përmes shfrytëzimit më efikas dhe efektiv të burimeve, me synim për t'i plotësuar kërkesat e brendshme dhe ndërkombëtare, për të dhëna statistikore. Të gjitha prodhimet statistikore publikohën në mënyrë elektronike, por ka prej tyre që publikohën në letër siq është rasti me vjetarin statistikor. Publikimet bëhen në baza vjetore, tremujore, dhe mujore. Në baza vjetore publikohen: BPV me Qasjen e Prodhimit dhe Shpenzimeve, Rezultatet e Anketës Strukturore të Ndërmarrjeve, Indeksin e Harmonizuar të Çmimeve të Konsumit (IHÇK), Statistikat e Tregtisë së Jashtme, Llogaritë Qeveritare, Rezultatet e Anketës së PRODCOM-it, Rezultatet e Anketës së Ekonomive Bujqësore, Llogaritjet Ekonomike në Bujqësi, Indeksi i Çmimeve në Bujqësi, Rezultatet e Anketës së Mbeturinave Industriale, Komunale, Rezultatet e Mbeturinave të Trajtuara, Statistikat e Ajrit (GHGE), Rezultatet e Anketës së Fuqisë Punëtore, Anketa e Buxhetit Familjar, Të dhënat për Shëndetësinë, Arsimin, Mirëqenien Sociale, Jurisprudencën, për Kulturen, të dhënat për Lindje, Vdekje, Shkaqet e Vdekjes, Kurorëzime, Shkurorëzime, Statistikat Gjinore. Vjetari Statistikor, Kalendari i Publikimeve, Katalogu i Publikimeve. Prodhimet statistikore që publikohën në baza tremujore: BPV me Qasjen e Prodhimit dhe Shpenzimeve, Llogaritë Qeveritare, Indeksi i Çmimeve të Prodhimit, Indeksi i Çmimeve të Importit, Indeksi i Kostos së Ndërtimit, Bilanci i Energjisë, Statistikat e Hotelarisë, Statistikat e Transportit, Statistikat e Tregtisë me Pakicë, Statistikat e Industrisë, Repertori Statistikor i Ndërmarrjeve, Indeksi i Çmimeve të Prodhimeve dhe Inputeve në Bujqësi, Rezultatet e Anketës së Fuqisë Punëtore dhe Buletini Tremujor.

Në baza mujore prodhohen këto publikime: Indeksi i Harmonizuar i Çmimeve të Konsumit (IHÇK) dhe Statistikat e Tregtisë së Jashtme.

ASK-ja, po ashtu redakton, mirëmban dhe rishikon regjistrat statistikorë vijues:

- Regjistrin e Popullsisë,
- Regjistrin e Ekonomive Familjare,
- Regjistrin e Banesave dhe Ndërtesave,
- Regjistrin Statistikor të Bizneseve,
- Regjistrin e Qarqeve Regjistruese,
- Regjistrin e Ekonomive Bujqësore,
- Regjistra dhe baza të tjera të të dhënave.

Disa prodhime realizohen në bashkëpunim me agjenci të tjera publike.

Sipas Ligjit të Statistikave Zyrtare në Kosovë, ASK-ja duhet të zhvillojë statistika sipas standardeve të BE-së. Qëllimi i prodhimit të statistikave është përmbushja e nevojave të shfrytëzuesve me të dhëna statistikore sipas standardeve të BE-së, si në prodhimin , ashtu edhe në cilësinë e statistikave. Raportet e publikuara vleresuse për ASK-në nga Komisioni Evropian (Eurostat-ti) dhe organizata tjera ndërkombëtare, rekomandojnë rritjen e sasisë

dhe cilësisë së prodhimeve statistikore. Në këtë kontekst, ASK-ja ka bashkëpunuar ngushtë dhe do të vazhdojë të bashkëpunojë me partnerët ndërkombëtarë, me qëllim të rritjes së cilësisë së statistikave zyrtare konform standardeve ndërkombëtare në fushën e statistikave zyrtare.

4. VLERËSIMI I PERFORMANCËS

Monitorimi i zhvillimit të proceseve statistikore në ASK, është proces përmes të cilit, ASK-ja, siguron informacion mbi performancën vjetore paraprake. Ky proces monitorimi realizohet përmes (vegël menaxheriale) të ashtuquajturës kornizë e vlerësimit të performancës (KVP). Në këtë mënyrë monitorohen të gjitha aktivitetet dhe në çdo vit me mundësinë e ri-vlerësimit të prioriteteve strategjike në varësi të të arriturave. Procesi i matjes së performancës ka filluar së zbatuari që nga viti 2013 mbi bazën e objektivave të caktuara në Programin e Statistikave Zyrtare dhe zbatimi i këtyre objektivave është operacionalizuar në planet vjetore të punës (PVSZ 2013-2017). KVP-ja, mbulon disa aspekte të performancës dhe është e projektuar për ta përfunduar evidencën e bazuar në procesin e planifikimit, ku performanca e vërtetë lejohet të ndikojë në drejtimet vepruese.

Gjatë gjithë procesit, gjegjësisht ciklit të zbatimit të PSZ 2013 – 2017, përmes KVP-së (në përbërje të së cilës janë 8 tregues kyç) është bërë vlerësimi, respektivisht matja e performancës për vitin paraprak, duke identifikuar progresin në fusha të ndryshme sektoriale statistikore. Me fjalë të tjera, është zbatuar skema e planifikimit në formë cikli “Planifiko-monitoro-vlerëso-vepro”. Gjatë planifikimit për vitin vijues (2018), në muajin maj të vitit aktual (2017) ASK-ja vlerëson prioritetet e saj të veprimit nga pikëpamja e performancës në të kaluarën, respektivisht nga performanca e vitit paraprak (2016).

KVP-ja identifikon tetë (8) tregues kryesorë të performancës dhe katër (4) fusha të vlerësimit, duke i mbuluar aspektet, si: produktivitetin, përafrimin me BE-në, saktësinë në orar, afatet kohore, krahasueshmërinë dhe cilësinë. Tek disa tregues progresi është përtej pritjeve të caktuara (1, 3, 4 dhe 6) tek treguesit 5 dhe 8 ka progres ndër vite por ende jo në nivel të kënaqshëm ndërsa tek treguesi 2 vlerat ende janë ato të vitit 2013 për shkak të kohës së nevojshme për t'i zhvilluar. Megjithatë, për indikatorin 7 matja e publikimeve të reja në seri kohore është e mundur nga diferenca në mes të gjendjes në fillim (2012) dhe në fund të vitit 2016. Nga viti 2012 (vlerësimi 39 produkte) numri i publikimeve është rritur në 57 produkte statistikore. Diferenca pozitive prej 18 produkteve brenda kësaj periudhe paraqet edhe numrin e produkteve të reja në seri kohore (periudhe krahasuese të paktën 3 vite). Po ashtu për indikatorin 8 është duke u bërë progres në vlerësimin e gabimit në mostër. Për treguesit 1 dhe 3, si dhe 5 dhe 6, statusi i tyre për 2012 veç është i ditur (39 prodhime). Ndërsa, për treguesin 4, të dhënat e plota kanë filluar në vitin 2013. Pasqyrat në vijim ilustrojnë statusin e tetë (8) treguesve të KVP-së:

Treguesit e rezultuar	Statusi 2012/2016	Synimi për 2018
1 Numri i produkteve	Rritja e prodhimit nga 39 në 57 produkte në vitin 2016 (vëllimi i prodhimit në 2016 është rritur mbi 68% në krahasim me vitin 2012).Respektivisht, nga 79 në115 raporte statistikorenë 2016).	46 produkte (16% rritje)

2	Gjithsej numri i variablave	Për t'u mbledhur/grumbulluar nga përshkrimet e produkteve	Dokumentimi i variablave për 14 produkte.
3	Gjithsej numri i treguesve kryesorë (BE- Lista e treguesve kyç statistikorë për vendet kandidatet)	Numri i treguesve kryesorë ka shënuar rritje pozitive nga 38/86 në 73/109 në vitin 2015 krahasuar me vitin 2012 (referenca: Doracakut i Eurostatit, edicioni 2014/2017, shprehur në % nga 45% në vitin 2012 në 67% në 2015. ³	20% rritje (46)

Treguesit e rezultuar	Statusi 2013/2016	Synimi për 2018	
4	Ditë pune-për njeri/produkt	Numri mesatar i ditë-pune/produkt në vitin 2016, krahasuar me vitin 2013, (për produktet e njëjta), ka shënuar një rritje të lehtë prej 0.7%, gjegjësisht nga 147 në 148 ditë-pune/produkt. Kurse viti 2016 në raport me vitin 2015, është regjistruar rënie të numrit të diteve per produkt (për të njejtin numër të produkteve 40) në shkallën prej (-9.6%), respektivisht nga 163 në 148 ditë për produkt, qka shpreh një efektivitet më të lartë në prodhim.	25% reduktim (153)
5	Kalendari kohor, nga fundi i periudhës referuese deri në publikim/produkt	Koha prodhuese në vitin 2016 në raport me vitin 2015, ka regjistruar një rënie në shkallën prej (-3%), respektivisht nga 6605 ditë në 6401 ditë. Kurse në raport me bazën (viti 2012) ka një rritje të lehte prej +2% (6278 ditë regjistruar në vitin 2012)	25% reduktim
6	Shkalla e publikimeve në kohë	Norma e publikimeve në kohë është rritur nga 62 % në 95 % në vitin 2016 krahasuar me vitin 2012. Ky është një përmirësim i rëndësishëm i cilësisë, respektivisht i publikimeve në kohë.	98% publikimeve në kohë
7	Seritë kohore të publikuara	Nga viti 2012 (vlerësimi 39 produkte) numri i publikimeve është rritur në 57 produkte statistikore. Diferenca pozitive prej 18 produkteve brenda kësaj periudhe paraqet edhe numrin e produkteve të reja në seri kohore (periudhe krahasuese të paktën 3 vite).	Seritë kohore të publikohen kurdo, që është e mundshme
8	Vlerësimi i gabimit në mostër	Është bërë llogaritja e vlerësimit të gabimeve në mostër për AFP-në, ABESH në 2016. Kurse, për vitin 2018 do të vazhdojë vlerësimi i gabimit në mostër për SBS-në dhe AEB-në dhe prodhimet e tjera.	Vlerësimi i gabimit në mostër do të publikohet për 14 produkte, deri në vitin 2018

Përmbledhje ekzekutive

Treguesit /vitet	2012	2013	2014	2015	2016
Treguesi 1. Produkte	39	40	46	51	57
Treguesi 1.a Publikime/raporte	79	90	103	114	115
Treguesi 4. Ditë/produkte të krahasueshme	-	147	166	163	148
Ditë/produkte sipas gjendjes (7278)	-	-	157	152	127
K. prodhuese për prod. të krahasueshme	6278	6211	6772	6605	6401
Treguesi 6. norma e pub. në kohë(%)	62	60	80	95	95

³ Për këtë tregues (3), të dhënat për vitin 2016 mbeten ato të vitit 2015, për shkak se pocket book edition 2017 e publikuar nga Eurostat-it përmban të dhënat e fundit për vitin 2015, të dhënat për vitin 2016 publikohen Tn+1, freskimi bëhet sapo të publikohet nga Eurostat-i.

Në kuadër të PSZ 2018-2022, pjesë e saj do të jetë edhe Korniza e Vlerësimit të Performancës me plotësimet përkatëse (mëtohet zhvillim te qëndrueshëm) për periudhën e re pesëvjeçare. Në këtë kontekst KVP-ja, në PSZ 2013-2017 kishte dhe do të vazhdojë edhe në programin e ri të statistikave zyrtare të ketë në fokus katër aspekte të vlerësimit vjetor (duke përfshirë dhe qëllimet):

- a) Zhvillimin e planifikimit të kornizës së punës në ASK,
- b) Përafrimin me BE-në,
- c) Kënaqshmërinë e përdoruesve,
- d) Njohjen për ASK-në.

Disa nga këto aspekte mund të reflektohen përmes 8 treguesve kryesorë (treguesi 3 përcjell numrin e treguesve të prodhuar nga ASK-ja e që përfshihen në publikimet e Eurostat-it në nivel regjional dhe ndërkombëtar. Në Eurostat, dërgohen të dhëna përmes sistemit eDAMIS dhe formave tjera si Excel, etj. dhe/ose mund të trajtohen përmes anketave. Aspektet c) dhe d) *gjatë vitit 2018 e tutje do të jenë prioritet duke vendosur dialog sistematik me përdoruesit për të identifikuar dhe plotësuar nevojat e shfrytëzuesve për të dhëna statistikore.*

4.1 Produktiviteti dhe efikasiteti

Shkalla e produktivitetit dhe efikasitetit edhe për periudhën e ardhshme (përfshirë edhe programin e ri të statistikave zyrtare 2018-2022) respektivisht për vitin 2018, do të vazhdoi të bazohet në treguesit përkatës 4-6. Një nga Objektivat e ASK-së ka të bëjë me shfrytëzimin e burimeve të saj, me qëllim që prodhimi i statistikave të bëhet në mënyrë progresive përmes rritjes së efikasitetit gjegjësisht, duke synuar zvogëlimin e vazhdueshëm të angazhimit të ditëve të punës-njëri për produkt, duke shkurtuar kohën e prodhimit të publikimeve dhe synimin permanent të publikimit të të dhënave kryesore në kohë. Synimet e sipër përmendura të vendosura si qëllime për vitet 2013-2017 janë realizuar por që rritja e produktivitetit dhe efikasitetit do të jetë në vazhdimësi edhe për periudhën 2018-2022.

Nga periudha e kaluar, duke filluar nga vitit 2012 janë krijuar të dhëna të mjaftueshme që tregojnë se treguesit 1, 3, 5 dhe 6 janë bazë e rëndësishme krahasuese për progresin e arritur dhe për synimet në periudhën e ardhshme njëvjeçare dhe pesëvjeçare.


KVP Treguesi 1 – Numri i produkteve

ASK-ja, në varësi të resurseve njerëzore dhe financiare liston prodhimin e statistikave zyrtare kryesore. Gjatë vitit 2016 janë prodhuar/publikuar 57 produkte statistikore, krahasuar me vitin 2015 që ishin 51. Ndërsa krahasuar me vitin 2012 (viti bazë) ASK-ja ka rritur numrin e produkteve statistikore për 18 produkte statistikore më shumë. Nga këto 57 produkte janë realizuar gjithsej 115 raporte statistikore (mujore, tremujore, vjetore dhe dyvjeçare), nga 79 raporte që ishin në vitin 2012 (39/79).

Gjatë vitit 2016, si prodhime shtesë ose produkte të reja janë statistikat e PRODCOM nga viti 2014, Statistikat e Tregtisë me Pakice në baza tremujore nga viti 2015, Llogaritë Qeveritare tremujore nga 2017, Statistikat e Ujit dhe Statistikat e Ajrit (GHGE), Anketa për Konsumin dhe Eficiencën e Energjisë, Bilanci Vjetor i Energjisë, Anketa mbi të Ardhurat dhe Kushtet e Jetesës, etj. Rritja e numrit të publikimeve është njëra ndër shtyllat (produktiviteti) e programit të statistikave zyrtare dhe zgjerimi i programit realizohet në varësi të burimeve

njerëzore dhe financiare, ka ndodhur për arsye së janë prodhuar produkte të reja statistikore. Një nga qëllimet e KVP është edhe matja e progresit nëpër kohë. Meqenëse se matja në kohë përfshin të paktën një periudhë kohore 5 vjeqare, të dhënat krahasuese në këtë plan vjetor do të jenë ato të vitit 2017 si vit i fundit në programin e statistikave zyrtare 2013-2017. Për derisa programi i ri i statistikave zyrtare do të përfshijë periudhen 2018-2022 dhe do të përgaditet deri në fund të vitit 2017. Në grafikun e poshtë shënuar është shfaqur trajektorja në drejtim të objektivit 2017. Në vitin 2013, prodhimi ishte pak më i lartë në krahasim me parashikimet, ndërsa në vitin 2014 rritja e produkteve ishte më e theksuar në krahasim me parashikimet i njeiti trend pozitiv ka vazhduar me rritje progresive edhe në vitet 2015 dhe 2016

Grafiku 1. Numri i produkteve të prodhuara 2012-2016



Siç shihet nga të dhënat e prezentuara përmes grafikut më lartë, objektivi i caktuar sipas PSZ 2013-2017, deri në fund të vitit 2017 ishte caktuar një rritje prej 16% krahasuar me vitin 2012. Respektivisht, nga 39 produkte statistikore në vitin 2012 në 46 produkte në fund të programit në vitin 2017. Ky objektivi është arritur në vitin 2014 dhe gjatë viteve 2015 dhe 2016 objektivi është tejkaluar duke prodhuar 51 respektivisht 57 produkte statistikore.

Objektivi prej 16% rritje të produkteve statistikore është arritur, përkatësisht është përmbushur që në vitin 2014, ndërsa me numrin e produkteve prej 57, respektivisht, 115 raporte statistikore për vitin 2016 është tejkaluar rreth 23.9 % krahasuar me objektivin për vitin 2017


Bazuar në përshkrimin e mësipërm pikë fillestare për periudhën 2018 – 2022 do të jetë gjendja e vitit 2017, ndërsa synim i vitit 2022 do të jetë 67 produkte.

KVP Treguesi 4 – Ditë pune për produkt

Siç është cekur më sipër një nga qëllimet e ASK-së ishte dhe mbetet rritja e efikasitetit në procesin e prodhimit statistikor. Të dhënat nga SIPK-u për këtë indikator janë funksionalizuar të plota në vitin 2013 dhe si të tilla kanë shërbyer për matjen e procesit të performancës nga viti në vit. Numri i produkteve në vitin 2013 ishte gjithsej 40 produkte, ndërsa koha mesatare e regjistruar në finalizimin e një produkti gjatë vitit 2013 ishte rreth 147 ditë pune për produkt. Koha e regjistruar do të përdoret si bazë për monitorimin e progresit, në drejtim të cakut (objektivit) 2017, për ta zvogëluar në 25% numrin e ditëve të punës për produkt. Kjo do të thotë, nga 204 ditë pune (për 39 produkte, viti 2012) që ishte vlerësuar në fillim të zbatimit të

programit të statistikave zyrtare të zvogëlohet në 153 ditë pune në 2017. Koha mesatare për prodhimin e një produkti ka variuar nga viti në vit dhe kështu gjatë viteve 2016 dhe 2017 pritjet ishin dhe mbesin që të kemi zvogëlim të raportit ditor për produkt, në krahasim me rezultatet e vitit 2015. Në vitin 2013, koha e regjistruar, ditë-pune për produkt, ishte 147, ndërsa në vitin 2014, kjo kohë është regjistruar 166 ditë pune për produkt me një rritje rreth 12.9%. Ndërsa, në vitin 2015 të dhënat nga sistemi i SIPK-ut tregojnë një rënie të lehtë prej - 1.8% për produktet e krahasueshme të vitit 2013. Ndërsa në vitin 2016 të dhënat nga sipku regjistrojnë numër (ditë pune) më të ulët në krahasim vitin paraprak nga 163 në 148 ditë-pune për produkt apo rreth - 9.2 % rritje e fiksitetit.

Grafiku 2. Numri i ditëve pune-njeri për produkt në vitet 2012-2016



Nga grafikoni i mësipërm shihet qartë se gjatë viteve numri i ditëve të punës për produkt ka shënuar rënie thënë me fjalë të tjera ka pasur një efikasitet në procesin prodhues ngase diferenca e ditëve nënkupton angazhimin në prodhimin e produkteve të reja. Programi i statistikave zyrtare përfshin periudhen 2013-2017 dhe caku apo objektivi në këtë tregues është arritur në vitin 2016 ku mesatarisht për prodhimin e një produkti është harxhuar rreth 148 ditë pune për produkt (për produktet e krahasueshme me vitin 2013, ndërsa të dhënat për vitin 2012 janë vlerësim).

KVP Treguesi 5 – Afati kohor (koha prodhuese⁴)

Treguesi 5 - Afati kohor, po ashtu ka rol qendror për vlerësimin e rritjes së efikasitetit në prodhim. Nje ndër qëllimet e ASK-së ishte dhe mbetet publikimi dhe shpërndarja e të dhënave statistikore sa më shpejtë që është e mundur për shfrytëzuesit. Ky tregues pasqyron të gjitha aspektet e proceseve, se si është i organizuar procesi i prodhimit, si një tërësi. Ky përfshin organizimin e stafit të punës, ndër lidhjen me përdorues dhe njësitë përkatëse të punës statistikore, si dhe marrëdhëniet me respondentët dhe agjencitë, që sigurojnë të dhënat e nevojshme.

Që nga viti 2012, numri produkteve dhe i publikimeve ka shënuar një rritje të konsiderueshme. Krahasimet duhet bërë (përshtatur) vetëm me pruduktet dhe publikimet e njëjta. Andaj, për vitin 2015 nuk janë përfshirë të dhënat për të gjitha publikimet, por vetëm për ato që janë publikuar në vitin 2012-2016. Të dhënat për vitin 2016, në raport me vitin 2012 tregojnë një rritje të kohës së përgjithshme prej 1.9%, ndërsa në raport me vitin 2015

⁴Koha e prodhimit nënkupton numrin e ditëve, nga periudha referuese deri në ditën e publikimit


tregojnë rënie në shkallën prej (-3%), që ende nuk është në linjë me objektivin e dëshiruar për vitin 2017.

Në tabelen 1. Janë prezentuar të dhënat në nivel të statistikave sektoriale respektivisht departamenteve përkatëse për kohën e prodhimit (për produktet e krahasueshme) për periudhën kohore 2013-2016 si dhe ndryshimi me vitin paraprak respektivisht vitin 2015. Të dhënat variojnë ndërmjet departamenteve madje edhe brenda departamentit nëpër vite për shumicën e publikimeve. Në statistikave ekonomike, të dhënat tregojnë një rritje të kohës prodhuese në krahasim me vitin paraprak (2014) edhe pse në raport me vitin 2013 është më e shkurtër. Ndërsa gjatë vitit 2016 koha prodhuese e regjistruar për produktet e njejta ishte 2985 ditë, që paraqet një rënie për -5% në raport me vitin paraprak. Koha e prodhimit në fushën e statistikave sociale derivon si pasojë e vonesës së mbledhjes së të dhënave nga burime të ndryshme administrative, si dhe problemet me analizat në Anketën e Fuqisë Punëtore (varësia të ekspertët e jashtëm). Megjithatë, në vitin 2015, koha e prodhimit në fushën e statistikave sociale ka shënuar një progres (shkurtim) të kohës prodhuese rreth (-19.7%) në raport me vitin 2014, në vitin 2016 koha e regjistruar është rritur për 1%.

Tabela1. Koha e prodhimit

Tregues i 5, viti 2016	Koha e prodhimit 2012	Koha e prodhimit 2013	Koha e prodhimit 2014	Koha e prodhimit 2015	Koha e prodhimit 2016	Ndryshimi (+/-)	Synimi (-25%) 2018
DSELLK	3553	3346	2934	3153	2985	-5.3%	
DSS	1450	1483	2476	1988	2012	+1%	
DSBM	1082	1102	1089	1071	1104	+3%	
DMTI	193	280	273	393	300	-24%	
Gjithsej	6278	6211	6772	6605	6401	-3%	4709

Grafiku 3. Koha prodhuese 2013-2016 dhe objektivi sipas PSZ 2013-2017



Në Grafikon e mësipërm është paraqitur trajektorja drejt objektivit 2017, që tregon performancën nëpër vite në nivel të ASK-së dhe pritjet e parapara me PSZ 2013-2017, për shkurtimin e kohës prodhuese në shkallën prej (-25%) në krahasim periudhën fillestare. Në këtë synim, mbetet ende për tu bërë.

KVP Treguesi 6 – Saktësia në kohë (shkalla e publikimeve në kohë)

Një nga parimet e kodit të parimeve të statistikave evropiane (CoP), është publikimi i statistikave zyrtare në kohë respektivisht saktësia në kohë sipas kalendarit të publikimeve. Andaj përmes sistemit të SIPK-ut të dhënat për treguesin 6, rezultojnë me një performancë përtej pritshmërive nga objektivi i caktuar në PSZ. Plani strategjik i ASK-së ka caktuar si synim për 90% në vitin 2017. Publikimet në kohë tregojnë se nëse përdoruesit mund të presin statistika të disponueshme, siç janë paralajmëruar. Përmes KVP-së janë bërë analizat e tilla duke monitoruar proceset prodhuese dhe indikatorë tjerë të verifikueshem si dhe përmes anketës me përdoruesit siç është theksuar më lartë. Tabela 2 përshkruan gjendjen e publikimeve në kohë për vitet 2013 -2016.


Tabela 2. Publikimet në kohë/saktësia në kohë

Treguesi 6, viti 2016, Departamentet prodhuese	Proporcioni i prodhimit në kohë 2013	Proporcioni i prodhimit në kohë 2014	Proporcioni i prodhimit në kohë 2015	Proporcioni i prodhimit në kohë 2016	Synimi 2018, 98%
DSELLK	74%	90%	100%	100%	
DSS	6%	32%	70%	69%	
DSBM	71%	92%	100%	94%	
DTI	56%	89%	100%	100%	
ASK (total)	60%	80%	95%	95%	

Nga të dhënat e prezantuara në tabelën e mësipërme shihet një ngritje domethënëse e shkallës së publikimeve në kohë, sipas fushave gjatë viteve 2013-2016, si dhe synimi në shkallën prej 90%, sipas PSZ 2013-2017. Në vitin 2012 më pak se 60% e publikimeve publikoheshin në kohën e paraparë (58%), ndërsa objektivi i caktuar në PSZ është arritur madje tejkaluar në vitin 2015. Si rrjedhojë 95% e raporteve statistikore të ASK-se janë publikuar në kohë respektivisht, saktësi kohore sipas kalendarit të publikimeve. Gjatë kësaj periudhe (2012-2016) ka rritje për 37%, respektivisht, nga 58% në 95% të publikimeve të publikuara në kohë.

Ngasa u tha më lartë ASK-ja, do të vazhdojë me synimet për shkurtimin e kohës prodhuese dhe të rrisë, sa më shumë që është e mundur, numrin e publikimeve në kohë. Objektivi i caktuar deri në fund të vitit 2017 (90%) është arritur në vitin 2015, madje është tejkaluar në 95%.

Grafiku 4. Publikimet në kohë



Përveç formës tabelare performanca për saktësinë në kohë është prezentuar edhe në formë grafiku duke përfshirë edhe vitin 2012. Në grafikun nr. 4 shihet qartë se norma e publikimeve në kohë në vitin 2012 ishte 58%, në vitin 2013 ishte 60%, në vitin 2014 ishte 80%, ndërsa në vitin 2015 dhe 2016 ishte 95%. Trajektorja e shfaqur në grafik tregon se norma e publikimeve në kohë është përmirësuar në bazë të objektivit sipas Programit të Statistikave Zyrtare 2013-2017. Në bazë të kësaj, ASK-ja do të përqendrohet në identifikimin dhe eliminimin e mundshëm të faktoreve të cilat kanë ndikuar në saktësinë e publikimit në kohë në fusha të veçanta si në (statistikat sociale).

4.2 Prodhimi

Siç është cekur në PSZ 2013-2017, po ashtu edhe në periudhën e ardhshme pesvjeqare, ASK-ja, në vazhdimësi planifikon ta përmirësojë gamën e prodhimit. Për ta matur zhvillimin e gamës së prodhimit dhe përafrimin me BE-në janë përdorur tri masa:

- Numri i publikimeve,
- Numri i variablave, dhe
- Numri i treguesve kryesorë (Pocket book edition 2017”, Eurostat)

Prodhimi i përgjithshëm është në rritje. Siç është treguar në pjesën e parë 4.1, numri i produkteve dhe publikimeve është rritur nga viti 2012 në 2016, respektivisht nga 39/57 dhe 79/115. Për ta klasifikuar normën e rritjes, ASK-ja, ka filluar me monitorimin e publikimit të Eurostatit (“Pocket book edition 2014-2017”) i cili përfshin të dhëna nga vendet e BE-së dhe regjionit. Raporti i fundit “Pocket book edition 2017” përfshin të dhënat e fundit me referencë të dhënat për vitin 2015. Ndërsa, lista e numrit të variablave duhet të bëhet gjatë procesit të dokumentimit të një numri të caktuar të produkteve.

KVP Treguesi 2 – Numri i variablave

Numri i variablave në vazhdimësi gjatë të gjitha planeve vjetore ka qenë si synim por që ende nuk është arritur të finalizohet. Ky numër do të numërohet në nivel produkti dhe çdo produkt duhet ta dokumentojë përshkrimin e tij. Dokumentimi i variablave do të bëhet me një proces të veçantë, në kuadër të Projektit për Metadata. Megjithatë, faza fillestare e Projektit për Metadata (duke ndjekur standardet e BE-së, ESMS) nuk përfshin një dokumentim të tillë të variablave. Në vend të kësaj, një bazë e shënimeve për metadata do të përdoret për mbledhjen dhe dokumentimin e variablave. Puna në krijimin e një bazë të shënimeve për metadata mund të fillojë më vonë, respektivisht në vitin 2017-2018. Megjithatë, puna në definimin dhe dokumentimin e variablave mund të fillojë edhe para kësaj periudhe.


Në fund të viti 2015 është bërë përshkrimi i 11 produkteve (metadave) dhe ka vazhduar deri më tani (maj 2016), ku janë dokumentuar gjithsej 14 produkte. Ndërsa, deri në mars të vitit 2017 është përfunduar përshkrimi për 25 produkte. Pritet të përfundohet me dokumentimin e të gjitha produkteve statistikore, brenda kornizës së programit 2013-2017. Kurse, përshkrimi i variablave nuk është përfshirë në këtë proces. Megjithatë, ASK-ja ka në plan, që deri në fund të vitit 2017, ta krijojë një sistem për të filluar me dokumentimin e variablave konform definicioneve ndërkombëtare në fushën e statistikave.

KVP Treguesi 3 – Numri i treguesve kryesorë (Lista e BE-së 2012)

Ky tregues është përcaktuar të jep një lloj vlerësimi për përafrimin me BE-në, duke monitoruar numrin e treguesve kryesorë, të publikuar nga ASK-ja në *Doracakun e Eurostatit për Vendet e Zgjerimit Pocket book edition 2017*.

Numri i treguesve të publikuar nga ASK-ja ka një rritje të lehtë ndër vitë. Ka një rritje të të dhënave dhe tabelave të ASK-së, respektivisht të Kosovës, të përfshira në *Doracakun dhe "Key Figures" të Eurostatit* për vitin 2014 deri në vitin 2017. Kështu, në vitin 2015, Kosova ka qenë e përfshirë në këtë Doracak me 67%, krahasuar me vitin 2012, që ishte e përfshirë me 45%. Ky përmirësim paraqet përafrimin e Statistikave të Kosovës me BE-në, si dhe rritjen e vëllimit të prodhimit.⁵

Grafiku 4. Pjesëmarrja e Kosovës me të dhëna në Doracakun e BE-së, (shprehur në %)



Nga të dhënat e prezantuara në grafik, shihet qartë rritja e vazhdueshme e përfshirjes së Kosovës me të dhëna në publikimet e Eurostatit. Nga 45% në vitin 2012, me një rënie të lehtë në vitin 2013, dhe me një rritje deri në 59% në vitin 2014, që ka tejkaluar edhe objektivin e vënë për 2017. Ndërsa në vitin 2016 përfshirja është me 67% gjegjësisht nga 109 indikatorë Kosova përfshihet me 73 sosh. Të dhënat për vitin 2016 janë të njëjta me vitin 2015 për shkak se publikimi i fundit "Pocket book edition 2017" i referohet të dhënave të vitit 2015.

4.3 Cilësia

Sipas Ligjit për Statistika Zyrtare, statistikave zyrtare grumbullohen, përpunohen, prodhohen dhe shpërndahen në bazë të standardeve dhe metodave të harmonizuara të Eurostatit. Gjatë të gjitha proceseve të lartcekura zbatohen komponentë të cilësisë si: relevanca, saktësia, afatet kohore, saktësia në kohë, qasja dhe qartësia, krahasueshmëria si dhe koherenca.

Aktualisht ASK-ja është në proces të zhvillimit të planit për të menaxhuar përmirësimin e cilësisë dhe parimet për dokumentim -metadatat. Kjo detyrë është që t'i inkuadrojë metodat statistikore, të pranuar nga BE-ja dhe nga komuniteti ndërkombëtar statistikor. Kjo do të bëhet hap pas hapi dhe duke shfrytëzuar rekomandimet nga Projekti i Binjakëzimit të

⁵Për këtë tregues (3)të dhënat janë prezentuar për vitin 2015 për shkak se broshura e Eurostat-it Pocket book edition 2017, përfaqëson të dhëna për vitin 2017 (T-2).

komponenta e Menaxhimit të Cilësisë, si dhe mbështetjen e Statistikave të Suedisë për Metadata. Sipas planifikimit në vitin 2017 do të bëhet përmirësimi i vazhdueshëm i cilësisë.

Gjatë vitit 2015 dhe 2016 është bërë matja e vlerësimit të gabimit në mostër për produktet AFP, ABESH, ndërsa për vitin 2018 do të vazhdohet për produktet e tjera.

Qëllim afatgjatë është që të matën në tërësi të gjithë komponentët e cilësisë, në mënyrë që të arrihet progres në Sistemin Statistikor të Kosovës dhe në plotësimin e standardeve të BE-së. Me PSZ 2013-2017 është arritur progres në seritë kohore dhe matjen e vlerësimit të gabimeve në mostër, ndërsa në periudhen 2018–2022 gjithashtu do ti kushtohet rëndësi e veçantë përmirësimit të cilësisë.

KVP Treguesi 7 - Publikimi i serive kohore

Një aspekt i rëndësishëm i cilësisë (dhe planifikimit) të statistikave zyrtare është mundësia për t'i krahasuar të dhënat nëpër kohë. Prandaj, të dhënat për seritë kohore do të shtohen në përshkrimin e produkteve të ASK-së. ASK-ja bën publikimin e të dhënave në seri kohore, ku të përshkrimi i produkteve theksohet (bëhet e ditur) zanafilla e publikimit dhe nëse eventualisht ka pasur ndërprerje të serive kohore.

KVP Treguesi 8 – Vlerësimi i gabimeve në mostër

Një ndër komponentët kryesorë të cilësisë është saktësia e të dhënave, respektivisht matja e intervalit të besueshmërisë së të dhënave statistikore. Për anketa me mostër, gabimi i mostrës do të dokumentohet në përshkrimin e produktit, kurdo që është e mundur duke u mbështetur në Projektin 2013-2017 ndërmjet ASK-së dhe SIDA-s. ASK-ja tanimë ka bërë vlerësimet e gabimit në mostër për disa anketa si p.sh. për 2 produkte në vitin 2016 dhe 2 produkte të planifikuara për vitin 2017.

Llogaritjet e gabimit në mostër për Anketën e Fuqisë Punëtore (AFP) dhe për Anketën e Buxhetit të Ekonomive Familjare (ABEF) janë bërë gjatë vitit 2015 dhe të njëjtat janë publikuar gjatë vitit 2016. Vlerësimi i gabimit në mostër, do të zbatohet edhe të anketat e tjera statistikore. Per Anketën e Ekonomive Bujqësore llogaritjet janë në proces e sipër ndërsa për Anketën Strukturore të Bizneseve (ASB) gjatë vitit 2017.

Duke u bazuar në rezultatet e realizimit të PSZ 2013-2017 dhe me qëllim të zbatimit të Parimit të Cilësisë nga Kodi i Praktikës mbi Statistikat Evropiane, me PSZ 2018-2022 synohet të arrihet implementimi i komponentëve të tjera të cilësisë sic është cekur edhe me lartë (Relevanca, Saktësia, afatet kohore dhe përpikmeria apo saktësia në kohë, qasja dhe qartësia e të dhënave si dhe krahasueshmëria

4.4 Korniza e planifikimit

Korniza e planifikimit të ASK-së ka filluar të adresohet që në fillim të vitit 2012. Gjatë kësaj periudhe kanë ndodhur zhvillime të rëndësishme si:

- Zhvillimi i instrumentëve (module) të reja në procesin e planifikimit;
- Riorganizimi i ASK-së;
- Draftimi i plotësim-ndryshimit të Ligjit për Statistika Zyrtare, sipas rekomandimeve të Eurostat-it;
- Hartimi dhe aprovimi i rregulloreve dhe udhëzimeve administrative;

- Arritja e marrëveshjeve të mirëkuptimit me institucionet e tjera;
- Aplikimi i SIPK-ut dhe avancimi i tij;
- Aplikimi i KVP-së;
- Hartimi i Hartave Rrugore për vitet përkatëse;
- Hartimi i Programit Kombëtar për zbatimin e MSA-së në fushën e statistikave;
- Hartimi i Strategjisë dhe Politikës për Diseminim (Shpërndarjes së të dhënave statistikore);
- Hartimi i planeve vjetore sipas Ligjit për Statistikat Zyrtare;
- Hartimi i planeve vjetore të punës së Qeverisë në fushën e statistikave.
- Programi i reformave në Ekonomi (pjesa e Statistikave)

4.4.1 Instrumentët e planifikimit

Parashikueshmëria dhe pasqyra e përgjithshme e prodhimit – si bazë për planifikim, prioritet dhe vendimmarrje – janë përmirësuar me publikimin e Programit të Statistikave Zyrtare, PSZ 2013-2017, Planet Vjetore 2013-2018, “dokumentet drejtuese”, hartën rrugore dhe Kornizën për Vlerësimin e Performancës (KVP).

PSZ, 2018-2022⁶ përfshinë një kornizë veprimi 5 vjeçare, prioritetët strategjike për zhvillimin organizativ si dhe në fushën e statistikave, (disa prej të cilave pjesërisht kanë munguar dhe zgjerimi dhe përmirësimi i atyre ekzistuese). PSZ 2018-2022, po ashtu e definon Kornizën për Vlerësimin e Performancës, përfshirë rezultatet kyçe nga prodhimi statistikor– kënaqshmërinë e përdoruesve, efikasitetin e prodhimit, cilësinë e prodhimit, monitorimin e përputhshmërisë me statistikatat e BE-se etj.

Struktura e PSZ-së 2018-2022, PVSZ-së dhe KVP-së ofrojnë mundësi për një kornizë moderne të planifikimit, të bazuar në të dhëna, duke rritur orientimin e sistemit drejt rezultateve dhe duke ofruar bazën për:

- Procesin e prodhimit të dokumentuar – planifikim dhe zhvillim organizativ;
- Një komunikim transparent dhe të vazhdueshëm me përdoruesit;
- Një dialog transparent dhe të vazhdueshëm me Anëtarët e Sistemit dhe Këshillat Statistikor; dhe
- Krijimin sistematik të metadatave (përshkrim i produkteve dhe qasjes metodologjike).
- Vendimarrja bazuar në të dhëna (RBM)

Korniza planifikuese i integron apo komunikon me dy fazat me të rëndësishme të një cikli menaxherial planifikues siç janë planifikimi dhe raportimi duke nënkuptuar se Plani Vjetor është i bazuar drejtpërdrejt në vlerësimin e performancës në të kaluarën përmes analizes ne indikatorët e gjeneruar nga sistemi i SIPKut dhe njësive tjera përkatëse.

KVP-ja, po ashtu krijon Sistemin e Përfshirjes së Kohës, për monitorimin e shpërndarjes së punës ditore për burime njerëzore. Raportet nga sistemi ju mundësojnë menaxherëve të ASK-së t'i identifikojnë vështirësitë dhe nevojat për kapacitetet dhe t'i riaranzhojnë proceset e punës për një efikasitet sa më të madh. Ky sistem u ofron menaxherëve një pasqyrë të nevojshme për ta mundësuar bashkëveprimin ndërmjet njësive të ndryshme punuese të

⁶ (PSZ 2018-2022 do të hartohet deri në fund të vitit 2017. (Prireja në kohë e planit 2018 para programit, është për shkaqe objektive respektivisht aktivitetit “peer review”)

statistikës. Sistemi i përfshirjes së kohës është avancuar nga viti në vit dhe do të vazhdojë të avancohet duke përfshirë module të reja në sistem për Menaxhimin e Performancës.

Si përmbledhje, Korniza e Planifikimit nëpër vitë është zhvilluar me sa vijon:

Në vitin 2012, ASK-ja:

- Ka hartuar Programin e Statistikave Zyrtare, PSZ 2013-2017, për Sistemin Statistikor Kombëtar;
- Ka hartuar Planin Vjetor të Veprimit, të orientuar drejt rezultateve për vitin 2013 (PVSZ 2013);
- Ka zhvilluar përshkrimin e proceseve të produkteve statistikore; dhe
- Ka hartuar Kornizën për Vlerësimin e Performancës (KVP).

Në vitin 2013, ASK-ja:

- Ka krijuar Departamentin e Politikave, Planifikimit, Koordinimit dhe Komunikimit;
- Ka krijuar Departamentin e Regjistrimit dhe Anketimit;
- Ka zbatuar Sistemin e Përfshirjes së Kohës (SIPK), për monitorimin e shpërndarjes së kontributit të burimeve njerëzore; dhe
- Ka bërë progres në përshkrimin e unifikuar të produktit (standard i BE-së).

Në vitin 2014, ASK-ja:

- Ka bërë draftimin e Koncept-dokumentit dhe draftin e parë të plotësim-ndryshimit të Ligjit mbi Statistikat Zyrtare, me qëllim të fuqizimit të pavarësisë së ASK-së;
- Ka bërë Plotësim-ndryshimin e Ligjit për Regjistrimin e Bujqësisë;
- Ka finalizuar dhe publikuar Raportin Vjetor 2013, lidhur me performacën e ASK-së në përputhje me KVP-në;
- Ka zhvilluar Anketën mbi Kënaqshmërinë e Përdoruesit;
- Ka vazhduar zhvillimin e kapaciteteve të vetëvlerësimit të performancës;
- Ka bërë progres në zhvillimin e sistemit të vetë të reagimit të menaxhmentit;
- Ka vazhduar me ngritjen e kapaciteteve profesionale.

Në vitin 2015, ASK-ja:

- Ka vazhduar me rritjen e kapaciteteve të Departamentit të Planifikimit dhe Bordit të drejtorëve, për ta menaxhuar procesin e planifikimit (duke u përqendruar në efikasitetin e brendshëm dhe cilësinë statistikore në raporte analitike);
- Ka bërë zhvillimin e mëtutjeshëm të KVP-së dhe rritjen e kapaciteteve për analiza të performancës;
- Ka vazhduar me zhvillimin sistematik dhe proaktiv të platformave të TI-së për shpërndarjen e të dhënave (“user interface”);
- Ka vazhduar me zbatimin e qasjes në menaxhim bazuar në rezultatë (RBM);
- Ka vazhduar me procesin e dokumentimit të produkteve statistikore (metadata);
- Ka zhvillimuar Sistemin “Data bank”; PX ueb platforma
- Ka përgatitur dhe publikuar Politikën dhe Strategjinë e Diseminimit;
- Ka bërë shpalljen e rezultateve përfundimtare të Regjistrimit të Bujqësisë, 2014.

Në vitin 2016, ASK-ja :

- Përmbylljen e procesit të Plotësim-ndryshimit të Ligjit mbi Statistikat Zyrtare dhe
- Hartimin e Planit Vjetor për vitin 2017;

- Fuqizimin e kapaciteteve administrative dhe profesionale të ASK-së;
- Avancimin e KVP-së dhe rritjen e kapaciteteve për analiza të performancës duke përfshirë raportet analitike;
- Zhvillimin e vazhdueshëm, sistematik dhe proaktiv të platformave të TI-së për shpërndarjen e të dhënave (“user interface”);
- Menaxhimin e bazuar në rezultatë (RBM);
- Dokumentimin e variablave dhe produkteve statistikore (metadata).
- Monitorimin e aktiviteteve kryesore përmes të ashtuquajturave” dokumentet drejtuese”
- Hartimin dhe zbatimin e Hartës Rrugore 2017
- Rishikimi i PKZMSA në fushën e statistikave
- Procesi i parapërgaditjeve për “Peer review”
- Rishikimi i dokumentit për programin e reformave në ekonomi (PRE) në fushën e statistikave
- Zbatimi i i pilot projekteve të ndryshme në statistikat zyrtare, përkrahur nga Eurostati
- Rishikimi i matrices planifikuese për përkrahje statistikave zyrtare nga SIDA
- Përgaditja e raportit vjetor të punës së ASK-së 2015

Në vitin 2017 ASK-ja ka planifikuar :

- Hartimin e Planit Vjetor për vitin 2018;
- Hartimin e Programit të Statistikave Zyrtare 2018-2022;
- Vazhdimin e komunikimit me përdorues;
- Rritjen dhe zhvillimin e kapaciteteve administrative dhe profesionale të ASK-së;
- Avancimin e KVP-së si dhe fuqizimi i i kapaciteteve për analiza të performancës (raporte analitike, moduli i vlerësimit të kostos së produktit statistikor, etj);
- Digjitalizimi i anketave në teren si dhe krijimi i sistemeve të avancuara për shkëmbimin e të dhënave ndërinstitucionale (në mes të ASK dhe ITR);
- Fuqizimi i sistemit për shpërndarjen e të dhënave përmes platformës (“ASKDATA”);
- Promovimi gjithnjë e më shumë i platformës ASKDATA
- Mirembajtja e ueb-faqes së re të ASK-së;
- Menaxhimine bazuar në rezultatë (RBM);
- Dokumentimine variablave dhe produkteve statistikore (metadata);
- Vazhdimi i parapërgatijeve për procesin e vlerësimit të Sistemit Statistikor të Kosovës (Peer Review).

4.4.2 Riorganizimi

Me qëllim të rritjes së efektivitetit dhe efikasitetit në proceset prodhuese dhe administrative duke u bazuar në raportet e gjeneruara nga SIPK-u, me qëllim të racionalizimit të vendeve të punës dhe prioriteteve të përgjithshme të ASK-se, procesi i riorganizimit do të zbatohet sipas Rregullores Nr. 01/2013 për riorganizimin e brendshëm dhe sistematizimin e vendeve të punës në ASK deri në nivel deprimenti. Për realizimin e synimit të lartëcekur gjatë periudhës së ardhshme planifikohen këto veprime:

1. Fuqizimi i kapaciteteve administrative dhe profesionale me qëllim të arritjes së objektivave

2. Rritja e kapaciteteve në departamentet e tjera;
3. Racionalizimi i vendeve të punës në ASK përmes transfereve të brendshme.
4. Rialokim të resurseve sipas të dhënave të KVP
5. tjera

Në terma afatgjatë, Riorganizimi në ASK do të jetë një proces i vazhdueshëm, duke e respektuar Rregulloren përkatëse për Riorganizim, me qëllim të plotësimit të kërkesave dhe nevojave të ASK-së, në veçanti, dhe Sistemit Statistikor në përgjithësi.

4.5 Standardet e BE-së për cilësinë

BE-ja ka rregullore të caktuar për çështjen e cilësisë. Cilësia, në përgjithësi përkufizohet me metodologjinë e prodhimit, cilësinë e përpunimit, saktësinë e të dhënave, kohën e duhur për publikimin e të dhënave, krahasueshmërinë, etj. ASK-ja është duke u angazhuar në vazhdimësi në plotësimin e standardeve të BE-së, duke u bazuar në rregulloret për cilësinë. Për vitin 2017, ASK-ja ka planifikuar ta vazhdojë përmirësimin dhe zhvillimin e procesit të dokumentimit për metodat e prodhimit (metadatat).

Do të vazhdohet me zbatimin e dy llojeve të vlerësimit. Njëri është vlerësimi teknik, që përqendrohet në metodat dhe dokumentimin e prodhimit (metadatat) dhe tjetri është i orientuar drejt përdoruesit, që synon ta përmirësojë kënaqshmërinë e përdoruesit, duke i plotësuar në vazhdimësi kërkesat e tyre (zbatimi i Politikës dhe Strategjisë së Diseminimit-Shpërndarjes).

Shih Kapitullin 5: Prioritetet strategjike.

Për t'i zbatuar standardet e BE-së për cilësinë janë shfrytëzuar rekomandimet, që kanë dalë nga Projekti mbështetës i Binjakëzimit, 2013-2015, konform parimeve të Kodit të Praktikës të Statistikave Evropiane.

4.6 Kënaqshmëria e përdoruesve

Kontaktet me përdoruesit e të dhënave janë thelbësore për përmirësimin e cilësisë dhe për zhvillimin e përmbajtjes së statistikave. Një mënyrë e rëndësishme për vlerësimin e cilësisë është matja e kënaqshmërisë së përdoruesve.

Gjatë viteve 2013-2015, ASK-ja ka zbatuar një proces të matjes së kënaqshmërisë së përdoruesve përmes një anketë të organizuar nga ASK-ja. Kjo formë e matjes së kënaqshmërisë është zbatuar përmes Anketës mbi Kënaqshmërinë me një numër të caktuar përdoruesish, ligjëratarave me studentë në universitete publike dhe private, tryeza me kryeredaktorë dhe redaktorë të mediave, konferencave të ndryshme me media dhe grupe të interesit. Të gjitha këto aktivitete janë analizuar dhe janë marrë në konsideratë nga ana e ASK-së. Gjatë viteve 2016 dhe 2017, disa prej deperamentëve prodhues të ASK-së kanë zhvilluar takime me shfrytëzues kryesor të të dhënave me qëllim identifikimit të nevojave për të dhëna statistikore dhe matjen e nivelit të kënaqshmërisë për të dhënat e publikura nga ASK-ja.

ASK-jap do të vazhdojë ta avancojë ueb-faqen e ASK-së me qëllim të plotësimit të nevojave të përdoruesve për të dhëna statistikore si dhe ta bëjë më të lehtë qasjen nga shfrytëzuesit në

të dhënat e ASK-së. Po ashtu do të vazhdojë të komunikojë përmes formave të ndryshme me përdoruesit e të dhënave statistikore.

4.7 Përmbledhja e vlerësimit të performancës

- Deri në vitin 2016, numri i produkteve statistikore është rritur për 18 sosh në krahasim me vitin 2012, respektivisht nga 39 në 57 produkte, si dhe janë publikuar 115 publikime në vitin 2016, përderisa ishin 79 publikime në vitin 2012.
- Numri i variablave është proces, që do të vazhdojë me aktivitete gjatë procesit të dokumentimit (metadata). Mirëpo, do të bëhet përditësimi i listës së variablave. Ky proces do të jetë sfidues për ASK-në deri në finalizimin e plotë të procesit të dokumentimit të variablave.
- Përfshirja e Kosovës me të dhëna në Doracakun e BE-së” Pocket book edition 2017” ka shënuar rritje të konsiderueshme, në vitin 2015 në raport me vitin 2014 ashtu edhe në seritë kohore. Në vitin 2015 nga gjithsej 109 indikatorë Kosova është përfshirë me 73 indikatorë respektivisht 67% në krahasim me vitin 2014 që ishte 59%. Të dhënat për vitin 2016 do të freskohën në fund të vitit vijues, pasi që të jetë publikuar Raporti “Eurostat pocket book edition 2018” për vendet në zgjerim nga Eurostat-i ;
- Rritja e efikasitetit është e evidente nga të dhënat e przentuara, gjatë vitit 2016 mesatarisht janë shpenzuar rreth 147 ditë pune për produkt, në krahasim me vitin 2015 që është 163 ditë pune (rënie për -10%);
- Koha prodhuese respektivisht afatet kohore (një nga parimet e CoP), ka shënuar përmirësim nga 6605 ditë në vitin 2015 në 6401 ditë në vitin 2016. Ç’ka do të thotë se shfrytëzuesit i kanë pasur në dispozicion të dhënat statistikore për 204 ditë respektivisht secili produkt për 5.2 ditë më herët në raport me vitin 2015. ($205/39=5.2$ ditë/produkt).
- Po ashtu saktësia në kohë, në vitin 2016 është regjistruar në shkallën prej 95% të raporteve në kohë, e cila në raport me vitin 2015 është po ashtu 95%. Megjithatë shikuar në interval tjetër kohor ka shënuar rritje të vazhdueshme me mbi 35% krahasuar me vitin 2012/58%. Objektivi i caktuar në PSZ, ishte në shkallën prej 95% të Programit 2013-2017.
- Vlerësimi i gabimit në mostër ka filluar si proces gjatë viteve 2014-2015. Janë bërë llogaritjet e vlerësimit të gabimit në mostër për dy anketat si AFP dhe ABESH, ku publikimi i tyre pritet gjatë muajit maj 2016. Ndërsa, gjatë vitit 2017 dhe 2018, ASK-ja, do të vazhdojë me publikimin e vlerësimit të gabimit në mostër dhe koeficientit të variacionit edhe për produktet e tjera si Anketa Strukturore e Bizneseve (ASB) dhe Anketa e Ekonomive Bujqësore (AEB).
- Koha e raportimit është proces i vazhdueshëm, i cili gjatë vitit 2016 ka shënuar progres në 98% ditë të raportuara.

5. PRIORITETET STRATEGJIKE

Në pjesën 4.3 të Programit të Statistikave Zyrtare 2013-2017⁷ janë paraqitur prioritetet strategjike, të cilat ndahen sipas fushave organizative dhe statistikore. Lidhur me zhvillimin organizativ, plani pesëvjeçar përcakton 5 prioritete strategjike. Tanimë, disa nga këto prioritete janë realizuar, ndërsa disa janë në progres dhe do të mbesin edhe për vitin 2018 si në vijim:

Prioriteti 1. Avancimi i procesit të planifikimit dhe Kornizës për Vlerësimin e Performancës (KVP)

Gjatë vitit 2018 do të vazhdohet me forcimin dhe avancimin e procesit të planifikimit dhe të monitorimit, respektivisht Kornizës së Vlerësimit të Performancës. Përveç avancimit të sistemit të SIPK-ut, (do të behet futja e moduleve të reja), perpilimi i raporteve analitike mbi bazën e sistemit të SIPK-ut është pjese avancimit të mëtejshem. Gjatë vitit 2016 janë hartuar dy raporte analitike (një 6 mujor dhe vjetor), ndërsa gjatë vitit 2017 dhe vitit 2018 do të vazhdohet me hartimin e këtyre raporteve të cilat shërbejnë për vendimmarrje nga menaxhmenti i lartë i ASK-se, lidhur me mënyrën e riorientimit të aktiviteteve (inputeve) në proceset statistikore gjatë viteve në vijim. Departamenti përgjegjës për zbatimin e këtyre synimeve është DPPKK. Viti 2017 është viti i përmbylljes së ciklit të PSZ 2013-2017 dhe bazuar në këtë, në fund të vitit 2017 do të bëhet matja e realizimit të objektivave për programin e statistikave zyrtare dhe në bazë të saj do të behet listimi i objektivave të reja me vitin bazë 2017. Bazuar në Ligjin mbi Statistikat Zyrtare, ASK-ja do ta hartojë Programin e dytë për Statistikave Zyrtare 2018-2022, si dhe Planin Vjetor të Statistikave Zyrtare për vitin 2018.

Prioriteti 2. Riorganizimi i ASK-së

Procesi i riorganizimit nga pikëpamja e funksionimit dhe efikasitetit është proces i vazhdueshëm (funksionaliteti organizativ dinamik), me qëllim të përbushjes së misionit të ASK-së dhe nevojave të përdoruesve me të dhëna statistikore të besueshme, në kohë, të sakta dhe të krahasueshme ndërkombëtarisht. Shikuar nga pikëpamja e realizimit të objektivave përmes Rregullores për Riorganizim, pothuajse riorganizimi si projekt/aktivitet gjatë 2014 dhe 2015, është kompletuar me përbushjen e qëllimeve kryesore (krijimi i dy departamentëve të reja, bashkimi i dy departamentëve në një të vetëm, ndryshimi gradual i rolit të zyrave rajonale, etj.). Në kuadër të Reformës së Administratës Publike të Kosovës, ASK-ja ka finalizuar klasifikimin dhe standardizimin e vendeve të punës sipas legjisllacionit në fuqi.

Riorganizimi në kuptimin e racionalizimit të shfrytëzimit të burimeve njerëzore do të vazhdojë edhe në vitin 2017 dhe 2018 sipas prioritetëve të ASK-së në fushën e statistikave për tregues makroekonomikë, plotësimin dhe sistemimin e pozitave në ASK, me qëllim të rritjes së efektivitetit dhe efikasitetit të ASK-së, në përbushjen e obligimeve kombëtare dhe atyre ndërkombëtare.

Prioriteti 3. Komunikimi me përdorues

Synimi i ASK-së është vendosja e një dialogu sistematik me të gjithë përdoruesit e Statistikave Zyrtare. Kjo përfshin edhe vendosjen e një koordinimi dhe bashkëpunimi me institucionet, që janë burim dhe njëkohësisht përdorues të të dhënave të ASK-së. Për realizimin e këtij synimi, ASK-ja do të mbajë takime me shfrytëzues të ndryshëm sipas

⁷ Programi i ri i Statistikave Zyrtare 2018-2022, do të përfshijë prioritetet strategjike për periudhën 5 vjeçare dhe zbatimin e tyre do të shtrihet në kohë dhe zbatohet përmes planeve vjetore të punës. Hartimi do të behet pasi të jete vlerësuar SSK nga Eurostat.

grupeve të caktuara të interesit për identifikimin e nevojave për të dhëna të reja statistikore dhe rritjen e cilësisë sipas kërkesave të shfrytëzuesve.

Momentalisht, ASK-ja është duke punuar ngushtë me Ministrinë e Financave dhe Bankën Qendrore të Kosovës, si prodhues zyrtar të statistikave. Gjithashtu, ASK-ja përmes marrëveshjeve të mirëkuptimit (MeM) ka rritur nivelin e koordinimit dhe të bashkëpunimit me institucione, që janë shumë të rëndësishme lidhur me burimin e të dhënave administrative. Gjatë viteve 2016-2017, janë arritur marrëveshje (në 2016 është arritur MeM në mes të ASK së dhe PK) dhe në vazhdimësi do të arrihen MeM edhe me institucione të tjera (ARC), që janë burime të rëndësishme të të dhënave administrative. Gjithashtu, ASK-ja ka në plan t'ifreskojë MeM-të, të nënshkruara vitë me parë. Koordinimi dhe bashkëpunimi me përdoruesit ka arritur një nivel të kënaqshëm bashkëpunimi, sidomos me takimet e rregullta të Këshillit Statistikor, ku janë të përfaqësuar shumë institucione qeveritare dhe joqeveritare.

Gjatë vitit 2018, ASK-ja do të krijojë mekanizma (keshilli konsultativ për ll/k dhe statistika ekonomike), që do ta rrisin bashkëpunimin e ASK-së, si prodhuese kryesore i statistikave zyrtare, me grupet e caktuara të interesit, me qëllim të identifikimit dhe përmbushjes së nevojave të përdoruesve. Ndërsa, sa i përket bashkëpunimit me përdoruesit ndërkombëtarë, planifikohet që të thellohet bashkëpunimi edhe më tej. Tashmë, është krijuar praktikë, që çdo vit të mbahen takime të përbashkëta vjetore me të gjitha organizatat ndërkombëtare dhe donatorët e ASK-së në fushën e statistikave. Në ndërkohë, përmes Programit eDAMIS, ASK-ja vazhdon dërgimin e të dhënave në Eurostat, sipas kërkesave dhe standardeve të BE-së.

Sa i përket vlerësimit të nevojave të përdoruesve, ASK-ja do të organizojë seminare, tryeza të rrumbullakëta, konferenca dhe të gjitha format e tjera të komunikimit, në mënyrë që të arrihet të merret një vlerësim sa më real për nevojat e përdoruesve për Statistika Zyrtare.

Në vitin 2018, përmes Anketës së Kënaqshmërisë së Përdoruesve planifikohet të merret një rezultat konkret, lidhur me kënaqshmërinë e përdoruesve të Statistikave Zyrtare. Kjo formë e re e komunikimit do të jetë e rregullt.

Prioriteti 4. Vlerësimi i Sistemit Statistikor të Kosovës

Gjatë vitit 2015 dhe 2016, ka filluar përgatitja e gjithë procesit (organizativ dhe dokumentues), lidhur me vlerësimin profesional të Sistemit Statistikor të Kosovës përmes procesit të të ashtuquajtur "Peer Review" nga Eurostat-ti, e që pritet të bëhet edhe në Kosovë në pjesën e parë të vitit 2017.

Të gjeturat e misionit gjegjësisht rekomandimet nga misioni i vlerësimit të procesit Peer Review për sistemin statistikor të Kosovës, do të jenë pjesë e procesit të planifikimit për periudhën afatshkurtër 2018 dhe afatmesme 2018-2022 si dhe për këtë qëllim do të krijohet një plan veprimi për zbatimin e rekomandimeve të ekipit vlerësues (Peers).

5.1 Zhvillimi i statistikave ekonomike

ASK-ja ka bërë progres të konsiderueshëm në fushën e Statistikave Ekonomike dhe Llogarive Kombëtare. Në kuadër të këtyre statistikave publikohen: Bruto Produkti Vendor (BPV) në baza të rregullta tremujore në Qasjen e Prodhimit dhe Shpenzimeve me Çmime Aktuale dhe Konstante. Indeksi i Harmonizuar i Çmimeve të Konsumit (IHÇK) (në baza mujore dhe vjetore),

Statistikat e Tregtisë së Jashtme (në baza mujore dhe vjetore), Që nga viti 2014 janë përpiluar dhe publikuar të dhënat e BPV-së me sistemin e ri ESA 2010 dhe revidimi i llogarive ekzistuese, Nga shtatori 2014 në këto statistika është zbatuar standardi i klasifikimeve ekonomike NACE Rev.2. Kurse, gjatë vitit 2015, për herë të parë është realizuar Anketa e PRODCOM-it dhe janë publikuar rezultatet e kësaj anketë. Në vitin 2016 është arritur që BPV në baza tremujore të publikohet T+90 ditë (sipas standardit), Nga viti 2017 kemi filluar me llogaritë qeveritare në baza tremujore. Po ashtu, është bërë progres në statistikafatashkurtëra (të Biznesit, Çmimeve, Tregtisë së Jashtme dhe Energjisë). Gjithashtu, është finalizuar edhe platforma e re e Regjistrimit Statistikor të Bizneseve.

ASK-ja vazhdon të ballafaqohet me vështirësi, lidhur me numrin e limituar të statistikave afatshkurtra të biznesit, me cilësi të besueshme dhe në linjë me standardet e Bashkimit Evropian, sipas metodologjisë ndërkombëtare. Publikimi i BPV-së sipas qasjes së përdorimit të tabelave të furnizimit dhe përdorimit (SUT) ende nuk është realizuar (për vitin referues 2013 dhe 2014 është në proces). Në mungesë të buxhetit nuk mund të bëhet publikimi i BPV-së nominale në bazë të Paritetit të Fuqisë Blerëse (PFB) gjatë vitit 2017.

Një nga prioritet kryesorë për ASK-në janë Statistikat Ekonomike dhe Llogaritë Kombëtare, për të cilat do të ketë angazhim për ta rritur kapacitetet prodhues, së paku deri në vitin 2018. Përmirësimin dhe avancimin e Statistikave Afatshkurtra të biznesit, përmirësimin e Regjistrimit Statistikor të Bizneseve, vazhdimin e vënies në përdorim të klasifikimeve të reja ndërkombëtare, si: Klasifikimit të Produkteve sipas Aktivitetëve (KPA).

Varësisht prej mundësive buxhetore, gjatë vitit 2017 planifikohet realizimi i projekteve për matjen e ekonomisë informale në Kosovë. Gjatë vitit 2018 (nëse do të ketë buxhet shtesë) planifikohet zhvillimi i anketës për investime dhe zhvillimi i anketës së përdorimit të Teknologjisë së Informimit dhe Komunikimit (TIK) nga bizneset.

5.2 Fushat e tjera statistikore dhe ndërlidhjet e tyre

Në raportet e Progresit të BE-së, për Kosovë në dy vitet e fundit, theksohet së është bërë një progres lidhur me infrastrukturën statistikore dhe po ashtu rekomandohet që bashkëpunimi i ASK-së me institucionet e tjera duhet të rritet. ASK-ja, duhet t'i përdorë, në mënyrë kompetente, të dhënat e disponueshme administrative për t'i përmirësuar statistikafatashkurtëra lidhur me arsimin, shëndetësinë, demografinë etj. Por nga ana tjetër, ASK-ja do të vazhdojë me vijimësinë e ABEF-it, fuqizojë LFS si dhe të vazhdojë me Anketën e Ekonomive Bujqësore (Anketa e Kulturave Bujqësore Bimore dhe Anketa e Blegtorisë), pasi është krijuar një kornizë bazë e mirë përmes Projekteve të Regjistrimit të Popullsisë 2011 dhe Regjistrimit të Bujqësisë 2014.

Koordinimi ndërmjet proceseve të ndryshme punuese ka vazhduar dhe do të vazhdojë të përmirësohet në ASK. Në vazhdimësi ASK-ja, i ka kushtuar rëndësi të madhe procesit të koordinimit të prodhimeve të ndërlidhura në fushën e zhvillimit të statistikave. ASK-ja do të jetë në funksion të përmbushjes së misionit të saj përmes përmbushjes së nevojave të shfrytëzuesve me të dhëna statistikore. Ofrimi i të dhënave statistikore të besueshme dhe kualitative do të lehtësojë vendimarrjen në hartimin e politikave zhvillimore. Projektet e mëdha siç janë Regjistrimi i Popullsisë 2011 dhe i Bujqësisë 2014 kanë përforcuar zhvillimin dhe koordinimin e proceseve statistikore.

Bazuar në Ligjin mbi statistikafatashkurtëra zyrtare ASK-ja, në vazhdimësi ka zhvilluar projekte të reja me qëllim të rritjes së numrit të indikatorëve dhe rritjes së kapaciteteve të saj në fusha të

ndryshme statistikore. Prandaj edhe gjatë viteve 2017 dhe 2018 ASK-ja do të vazhdojë me realizimin e projekteve të tilla sipas praktikave më të mira ndërkombëtare, me qëllim të avancimit të Sistemit Statistikor të Kosovës.

Modernizimi i proceseve statistikore në ASK është duke u zhvilluar në vazhdimësi, në mënyrë që t'i përafrojë statistikat e Kosovës, me ato të vendeve të Bashkimit Evropian dhe standardeve të Eurostat-it. Për ta arritur këtë, duhet të krijohet mundësia e ndjekjes së metodologjive të reja, për t'i grumbulluar (forma elektronike e mbledhjes së të dhënave) dhe përpunuar më shpejtë të dhënat statistikore. Gjithashtu, ASK-ja duhet ta marrë parasysh progresin e bërë nga agjencitë e tjera publike dhe t'i shfrytëzojë arritjet e tyre për interesat e saj.

5.3 Tabela përmbledhëse e zhvillimit organizativ më 2018

Zhvillimi organizativ duhet të synojë në përmirësimin e efikasitetit të prodhimit, dhe PSZ paraqet katër prioritetet vepruese për vitin 2018:

Brenda Kornizës së burimeve ekzistuese	Objektivi dhe përgjegjësia	Statusi 2016/2017 dhe plani 2018
1. Përdorimi dhe avancimi i Kornizës së Vlerësimit të Performancës (KVP)	<u>Objektivi:</u> Avancimi i një pasqyre të përgjithshme për proceset statistikore në ASK, më qëllim të përfundimit të Kornizës së Planifikimit. <u>Përgjegjës:</u> DPPKK	<u>Statusi:</u> SIPK-u është funksional dhe plotësimi i tij me kërkesat e reja nga departamentët do të vazhdojë gjatë vitit 2018. Përveç zyres qendrore janë futur në sistem edhe zyrat rajonale të ASK-së, janë krijuar forma të reja të raportimit, janë hartuar raporte analitike mbi treguesit e KVP-së, etj. <u>Plani:</u> Monitorimi në vazhdimësi i SIPK-ut për vitin 2017-2018; Avancimi dhe modernizimi i mëtejshëm i SIPK-ut (p.sh. përfshirja e kostos sipas produktit statistikor, freskimi me aktivitete të reja, etj.). Zgjerimi potencial i KVP-së me tregues të rinj, si shkalla (norma) e përgjigjeve nga respondentët, numri i klikimeve dhe shkarkimeve në ueb faqen zyrtare të ASK-së.
2. fuqizimi i kapaciteteve profesionale të DPPKK-së.	<u>Objektivi:</u> Kompletimi me staf i DPPKK-së dhe ngritja e kapaciteteve egzistuese përmes trajnimeve për planifikim, raportim dhe dokumentim. <u>Përgjegjës:</u> DPPKK	<u>Statusi:</u> Është zbatuar Rregullorja për Riorganizimin e ASK-së përmes plotësimit të pozitave dhe ushtrimit të përgjegjësive konform rregullores. Të gjitha pozitave në DPPKK i kanë përshkrimet e tyre të punës, <u>Plani:</u> Përmes partnerëve të jashtëm (Sida/SCB dhe partnerëve të tjerë të ASK-së) do të vazhdojë trajnimi në ngritjen e mëtejshme të kapaciteteve për fuqizimin e kornizës planifikuese dhe monitoruese konform kërkesave dhe nevojave për të dhëna statistikore të besueshme, të krahasueshme dhe në kohë.
3. Fuqizimi i i DRA-së.	<u>Objektivi:</u> Monitorimi/mbikëqyrja e punës në terren gjatë mbledhjes së të dhënave, me qëllim të rritjes së cilësisë së tyre. <u>Përgjegjës:</u> DRA	<u>Statusi:</u> Departamenti i Regjistrimit dhe Anketimit është i plotësuar dhe funksionon konform përgjegjësive të saj. Është realizuar lidhja e zyreve rajonale me ASK-në përmes rrjetit qeveritar të Teknologjisë Informative, si dhe qasja në sistemin e SIPK-ut. <u>Plani:</u> ASK-ja planifikon për vitin 2018 ngritjen e

4. Mbështetje departamentëve në digjitalizimin e Anketave dhe në vazhdimësi fuqizimi i ueb faqes së re të ASK-ës dhe platformës ASK-data.

Objekivi: Krijimi i programeve për mbledhjen e të dhënave në terren (metoda CAPI dhe CAWI) si dhe qasja më e lehtë në të dhëna zyrtare përmes ueb faqes së ASK-së

Përgjegjës: DMTI

kapaciteteve, me qëllim të rritjes së cilësisë gjatë mbledhjes së të dhënave, si dhe koordinimin më të mirë të punës në terren.

Statusi: Në ueb faqen e re të ASK-s është integruar platforma ASK Data dhe është në dispozicion për përdoruesit. askdata.rks-gov.net

Janë organizuar aktivitete të ndryshme të komunikimit me përdorues dhe Anketa mbi Kënaqshmërinë e Përdoruesve

Plani: Avancimi i përbajtjes së ueb faqes dhe platformës ASKDATA do të jetë i vazhdueshëm gjatë tërë vitit 2018.

Organizimi i seminareve dhe takimeve me përdorues

Vendosja e një moduli në ueb faqen e ASK-së për marrjen e kërkesave të përdoruesve

Jashtë Kornizës së burimeve ekzistuese	Objekivi dhe Përgjegjësia	Statusi 2016/2017 dhe plani 2018
1. Inkuadrimi i Metadateve	<p>Objekivi: Ngritja e kapaciteteve profesionale, dokumentimi i metadateve.</p> <p>Përgjegjës: DMTI në bashkëpunim me asistencën teknike të Sida/SCB</p>	<p>Statusi: Pjesëmarrja e stafit në trajnime përmes seminareve dhe punëtorive të ndryshme. Është bërë finalizimi i njëzet e pesë (25) produkteve për metadata deri në mars 2017</p> <p>Plani: Bashkëpunimi me projektin e Sida/SCB është duke vazhduar dhe në kuadër të projektit do të vazhdohet deri në përfundimin e të gjitha produkteve, sipas planit, deri në fund të vitit 2017.</p>
2. Koordinimi i veglave të të diseminimit/ shpërndarjes	<p>Objekivi: Finalizimi i listës së variablave dhe harmonizimi i serive kohore.</p> <p>Përgjegjës: DMTI</p>	<p>Statusi: Bashkëpunimi me Sida/SCB-në dhe Projektin e Binjakëzimit ka dhënë rezultatë të theksuara. Platforma ASKData është online.</p> <p>Plani: Prioritet deri më 2018 është që të gjitha të dhënat të shpërndahen përmes kësaj platformë (PX-Ueb).</p>
3. Përdorim më i mirë i metodologjive statistikore.	<p>Objekivi: Dokumentimi i të gjitha metodologjive dhe vlerësimet e tyre sipas standardeve të Eurostatit.</p> <p>Përgjegjës: DMTI</p>	<p>Statusi: Janë nxjerrë treguesit për vlerësimin e gabimit në mostër për dy produkte.</p> <p>Plani: Vazhdimi i dokumentimit të proceseve metodologjike për të gjitha produktet e bazuara në mostra.</p> <p>Vazhdimi i zbatimit të MZHePS (Modeli për gjenerimin/zhvillimin e proceseve statistikore)(ang.GSPBM)</p>

5.4 Tabela përmbledhëse në zhvillimin e fushave statistikore në vitin 2018

Për zhvillimin e fushave statistikore, PSZ 2018-2022⁸ për vitin 2018 parasheh këto aktivitete:

Brenda Kornizës së burimeve ekzistuese	Objektivi dhe përgjegjësia	Statusi 2016/2017 dhe plani 2018
1. BPV (PKSZ)	<p><u>Objektivi:</u> 1.Objektivi kryesor gjatë viteve 2017-2018 do të jetë rritja e numrit të produkteve dhe raporteve, përmirësimi i metodologjisë, respektivisht cilësisë së atyre ekzistuese, etj.;</p> <p>2.Përmirësimi i mëtëjmë i modelit për BPV-në në baza tremujore.Për këtë objektiv kërkohët rritja e numrit të stafit.</p> <p><u>Përgjegjës:</u> Departamenti i Statistikave Ekonomike dhe Llogarive Kombëtare (DSELLK).</p>	<p><u>Statusi:</u> 1.1 Gjatë vitit 2015, në kuadër të Projektit të Binjakëzimit ka filluar përpilimi i tabelave përdoruese dhe ofruese (ang. SUT) për vitin referues 2013 (nën progres). Gjithashtu në kuadër të pilot projektit IPA MB 2014 është duke u përpiluar SUT për vitin 2014 . Gjatë vitit 2017 është planifikuar publikimi i llogarive Qeveritare në baza tremujore</p> <p><u>Plani:</u> Planifikohet që gjatë vitit 2018 të vazhdohet me publikimin në kohë të BPV në baza tremujore T+90 ditë, llogarive Qeveritare T+90 ditë, BPV në baza vjetore T+9 muaj.</p> <p>2. Përmirësimi i modelit të BPV-së në baza tremujore do të jetë në proces edhe në të ardhmen. Vazhdimi i avancimit të përpilimit të tabelave përdoruese dhe ofruese (ang. SUT), fillimi i përpilimit të llogarive sektoriale, vlerësimin e informalitetët në sektorin real (bizneset)</p>
2. Anketa e Fuqisë Punëtore (PKSZ).	<p><u>Objektivi:</u> 2.1. Përmirësimi i cilësisë së të dhënave të AFP-së, në baza kuartale dhe vjetore si dhe shkurtimi i afateve kohore në publikimin e të dhënave</p> <p><u>Përgjegjës:</u> Departamenti i Statistikave Sociale (DSS)</p>	<p><u>Statusi: gjatë vitit 2016 ka filluar publikimi i të dhënave të AFP në baza tremujore</u>, në sajë të asistencës teknike të Bankës Botërore. Ndërsa në baza vjetore ka vazhduar publikimi si përmbledhje e publikimeve tremujore.</p> <p><u>Plani:</u> Për vitin 2018 planifikohet: 1.1Përditësimi i kornizës së mostrës për çdo vit, tre muaj para fillimit të anketës në terren; 1.2 Publikimi i rezultateve të AFP-së në baza tremujore sipas kalendarit të publikimeve të ASK-se në përpilim me afatet kohore të BE-së; 1.3 ngritja e kapacitetetve përmes asistencës teknike në kalkulimin e peshave; 1.4 rritja e numrit të indikatorëve të dërguar në Eurostat 1.4 Rritja e shkallës së monitorimit të grumbullimit të të dhënave në terren.</p>
3.Statistikat e Bizneseve (PKSZ)	<p><u>Objektivi:</u> 1. Përmirësimi i mbulueshmërisë së</p>	<p><u>Statusi:</u> 3.1. Në vitin 2016 kemi organizuar për herë</p>

⁸ Si është cekur edhe më lartë, plani 2018 do të jetë i inkorporuar në PSZ 2018-2022

Statistikave Strukturore të Ndërmarrjeve dhe Statistikave Afatshkurtra të Ndërmarrjeve. Përmirësimi i përzgjedhjes së mostrës, shkurtimi i afateve të publikimit, rritja e numrit të produkteve, rritja e cilësisë dhe zbatimi i klasifikimeve të reja.

Përqjegjës: Departamenti i Statistikave Ekonomike dhe Llogarive Kombëtare (DSELLK)

4. Çmimet (PKSZ)

Objektivi:

1. Shkurtimi i kohës së prodhimit për të gjitha indeksat e çmimeve.

Përqjegjës: DSELLK

të dytë Anketën për Klasifikimin e Produkteve, e njohur si PRODCOM (për vitin referues 2015. Rezultatet për vitin 2015 janë publikuar në dhjetor viti 2016 Gjithashtu janë bërë përgatitjet për anketën e radhës me vitë referues 2016 . Kjo anketë do të jetë e rregullt në baza vjetore. Të gjitha produktet janë publikuar në kohë, sipas kalendarit të publikimeve.

Plani: Planet për 2017-2018 janë rritja e produkteve, prodhimi i statistikave strukturore të ndërmarrjeve, sipas shtojcës VI (institucionet kredituese financiare); rritja e cilësisë si proces i vazhdueshëm, duke përmirësuar pyetësorët, përzgjedhjen e mostrës, mbikëqyrjen e mbledhjes dhe përpunimit të të dhënave; dhe realizimi i Anketës për Azhurnimin e RSB-së. Përmirësimi i statistikave të hotëlerisë duke përfshirë edhe lëvizjet (hyrjet dhe daljet e njerëzve në pikat kufitare)

Trajnimi i stafit përqjegjës për Statistikat e Biznesit (SSN dhe SASH) me aplikacion softuerik (mbështetur nga SIDA). Varësisht nga kapacitetet njerëzore synojmë zhvillimin e statistikave të ndërtimit, sipas metodologjisë dhe standardeve të Eurostatit. Do të vazhdojë shkurtimi i afateve të publikimeve, sipas objektivave të ASK-së

Statusi:

4.1 Nga janari 2016, Indeksi i Harmonizuar i Çmimeve të Konsumit (IHÇK) publikohet sipas klasifikimit COICOP, 5 shifror, i harmonizuar me standardet e Eurostatit.

4.2 Në vitin 2016 bazuar në rekomandimet e Eurostatit është ndërruar viti baza për kalkulimin e indeksëve (nga muaji maj 2002=100 kemi kaluar në mesataren vjetore 2015=100). Gjithashtu janë bërë të gjitha rikalkulimet e serive kohore (mujore dhe vjetore prej maj 2002 deri në dhjetor 2015. Këto ndryshime janë bërë me qëllim të integritit të të dhënave në Eurostat,

4.3 Me qëllim të zgjerimit të përfshirjes territoriale për IHÇK, është shtuar numri i vendburimeve, artikujve dhe shërbimeve si dhe i 3 komunave tjera (nga 10 në 13 komuna). Në më tëpër se 1 100 vendburime, gjatë muajit, mblidhen (monitorohen) më tëpër se 6 000 çmime, mbi 400 artikuj dhe shërbime (408).

4.4 Aplikacioni i ri për përpunimin e të dhënave të IÇIMP (i mbështetur nga SIDA) është në përdorim prej TM4 2016. Në vitin 2016 është filluar moduli për zbatimin e nomenklaturës së klasifikimit të produkteve sipas aktiviteteve (KPA). Gjatë vitit 2017 do të fillohet me publikimin në bazë të këtij klasifikimi.

4.5 Aplikacioni i ri për përpunimin e të dhënave të IÇP (i mbështetur nga SIDA)

vazhdon të përdoret nga viti 2016

Plani:

Gjatë vitit 2018 planifikohet:
Avancimi i metodologjisë së IHÇK-së Trajtimi i çmimeve për artikuj sezonal, përshtatshmëria e kualitetit dhe rekomandimeve tjera nga Eurostatit. .
Vazhdimi i zbatimit të programit për të gjithë indekset; zgjerimi dhe kompletimi i mostrës për IÇIMP, IÇP dhe IKN).
Të vazhdohet me Paritëtin e Fuqisë Blerëse (PFB) me pilot projektet e IPA 2015, (deri tani janë kryer 16 para-anketa dhe anketa).

Statusi:

5.1. Ka vazhduar shkurtimi i kohës së publikimit të Statistikave të Tregtisë së Jashtme në baza mujore dhe ato vjetore.

5.2.Zbatimi i veglave të PC-Axis për diseminimin interaktiv të të dhënave të Tregtisë së Jashtme është kryer.

Plani:

Do të vazhdohet me shkurtimin e afateve të publikimit nga T+25 ditë në T+24 ditë dhe me avancimin e platformës PX-Ueb.

Statusi:

6.1. Regjistrimi i Bujqësisë ka siguruar të dhëna bazë, në nëntor të vitit 2015, që do të përdoren për ta dizajnuar më mirë mostrën e AEB/ Anketën e Kulturave Bujqësore-Bimore dhe të Blegtorisë.

Plani:

Të shfrytëzohen edhe burimet admistrative që janë si potenciale edhe azhurnimin - freskimin e regjistrimit statistikor të ekonomive bujqësore si dhe janë potenciale për prodhimin e disa treguesve statistikor bujqësore.

Statusi:

6.2. Koha e prodhimit është 270 ditë.

Plani:

Qëllimi është të shkurtrohet kjo kohë në 180ditë.

5. Tregtia e jashtme (PKSZ)

Objektivi:

1. Shkurtimi i periudhës së publikimit.
2. Mundësia e qasjes interaktive për përdoruesit e të dhënave.

Përqejës:

DSELLK dhe DMTI

6. Anketa e Ekonomive Bujqësore– Anketa e Kulturave Bujqësore, Bimore dhe të Blegtorisë(PKSZ)

Objektivi:

1. Shfrytëzimi i Kornizës së mostrës nga Regjistrimi i Bujqësisë dhe dizajnimi i anketave të bujqësisë, sipas rekomandimeve të Eurostatit.
2. Shkurtimi kohës së prodhimit të rezultateve.

Përqejës:

DSBM

7. Statistikat e tjera për ekonomi familjare dhe individë (PKSZ).

Objektivi:

- 1 Rritja e numrit të treguesve për statistika të tjera sociale si (arsimit, shendetësisë dhe mirëqenies sociale) sipas kërkesave të organizatave ndërkombëtare.
-përmirësimi i cilësisë së të dhënave si dhe -shkurtimi i kohës së publikimeve .

Përqejës:

DSS

Statusi:

7.1.Janë ofruar të dhëna sipas pyetësorëve të dërguar nga ILO (të dhënat në tregun e punës, të cilat publikohen në web të ILO-s(të dhënat ofrohen çdo vit dhe ILO bënë krahasueshmërinë e shkallës së punësimit dhe papunësisë në nivel ndërkombëtar

8. Vlerësimi i popullsisë në baza vjetore (PKSZ).

Objektivi:

1. Vlerësimi i popullsisë në baza vjetore dhe rritja e treguesve lidhur me vlerësimin e popullsisë.

Përqiejës:

DSS.

9. Të dhënat administrative (PKSZ).

Objektivi

1. Identifikimi dhe avancimi burimeve të të dhënave administrative dhe marrja e tyre në formë elektronike.

Përqiejës:

Të gjitha departamentët prodhuese dhe mbështetëse

Plani:

Plotësimi i të dhënave të tregut të punës për Regional Cooperation Council(RCC) projekt ky i cili bënë krahasueshmërinë e të dhënave rajonale të Ballkanit Perëndimor me shtetët e tjera, plotësimi i të dhënave për Bankën Botërore dhe Wiener Institut fur Internationale Wirtschaftvergleiche(WIIW) projekt ky i cili krahason të dhënat e Ballkanit Perëndimor me shtetët e tjera (këto të dhëna do të plotësohen sipas kuartaleve dhe do të jenë më shumë se 1300 indikatorë)

Përditësimi i regjistrave nga burimet e brendshme statistikore, për t'i përmbushur kërkesat e organizatave të ndryshme dhe përdoruesve individualë, si: statistikat e shëndetësisë, mirëqenies sociale dhe të tregut të punës.

Përditësimi i regjistrave nga burimet e brendshme statistikore, për t'i përmbushur kërkesatë organizatave të ndryshme dhe përdoruesve individualë, si:statistikat e shëndetësisë, mirëqenies sociale dhe të tregut të punës.

Statusi:

8.1. Vlerësimi i fundit i popullsisë është bërë për vitin 2015.

Plani:

Do të vazhdojë vlerësimi i popullsisë për vitet pasuese, me mundësi të shtimit të treguesve të rinj. Vazhdohet me përdorimin e: të dhënave përfundimtare të Regjistrimit të Popullsisë 2011; të dhënave për lindjet dhe vdekjet; të dhënave për emigracion nga burimet vendore dhe ndërkombëtare.

Statusi:

Lista e institucioneve për furnizim me të dhëna administrative ekziston. Është nënshkruar Marrëveshja e Mirëkuptimit (MeM), me MASHT-in dhe Policinë Kosoves. Në MeM janë vendosur rregullat e dërgimit të të dhënave. Ka vazhduar marrja e të dhënave administrative nga institucionet e ndryshme: MPMS, MAP, Këshilli Gjyqësor i Pavarur i Kosovës, MBPZHR, MPPH, Instituti Kombëtar i Shëndetit Publik, ATK, Dogana e Kosovës, ARBK, Thesari, Trusti Pensional, etj.

Plani:

Të nënshkruhen MeM me ARC-në dhe me Ministrinë e Drejtësisë, si dhe të modifikohen MeM me BQK-në dhe MF-në.

Freskimi i MeM-ve të mëparshme.

Vazhdimi i i digjitalizimit të statistikave të arsimit, duke i përfshirë të gjitha nivelet e arsimit.

Publikimi i statistikave të arsimit të dalë si publikim i përbashkët ASK-MASHT.

Jashtë kornizës së burimeve ekzistuese	Objektivi dhe përgjegjësia	Statusi 2016/2017 dhe plani 2018
1. Regjistri Statistikor i Fermave (PKSZ).	<p><u>Objektivi:</u> 1.Përditësimi-azhurnimi i Regjistrin Statistikor të Fermave.</p> <p><u>Përgjegjës:</u> DSBM</p>	<p><u>Statusi:</u> 1.1 Është krijuar Regjistri i Ekonomive Bujqësore nga të dhënat e regjistrimit të bujqësisë 2014.</p> <p><u>Plani:</u> Gjatë vitit 2018 do të bëhet freskimi-përditësimi Regjistrin të Ekonomive Bujqësore nga burimet administrative dhe nga AEB 2017. Ky regjistër do të përdoret për anketa të ardhshme të bujqësisë.</p>
3. Anketa mbi të Ardhurat dhe Kushtët e Jetesës (AAKJ) (PKSZ)	<p><u>Objektivi:</u> Zhvillimi i Anketës mbi të Ardhurat dhe Kushtët e Jetesës, si dhe ngritja e kapaciteteve profesionale të stafit të ASK-së.</p> <p><u>Përgjegjës:</u> DSS</p>	<p><u>Statusi:</u> Gjatë vitit 2015 është zhvilluar një pilot anketë ndërsa gjatë vitit 2016 kanë vazhduar përgaditjet e nevojshme për fillimin e anketës së plotë në terren. Gjatë vitit 2017 do të zhvillohet anketa në terren siaps dinamikës së paraparë.</p> <p><u>Plani:</u> zhvillimi i anketës në teren do të fillojë në TM3/2017 Financimi i kësaj anketë është bërë nga BB . Planifikohet të vazhdojë ofrimi i asistencës teknike nga BE-ja, me qëllim të ngritjes së kapaciteteve profesionale, si dhe ofrimi i trajnimeve shtesë për stafin vendor, me fokus të veçantë në aspektin e analizimit të të dhënave.</p>
4. Anketa mbi TIK	<p><u>Objektivi:</u> Zhvillimi i Anketës dhe grumbullimi i të dhënave nga terreni si dhe ngritja e kapaciteteve profesionale të stafit të ASK-së.</p> <p><u>Përgjegjës:</u> DSS</p>	<p><u>Statusi:</u> Janë bërë përgaditjet e nevojshme dhe gjatë muajit prill 2017 ka filluar mbledhja e të dhënave nga terreni dhe do të perfundojë gjatë muajit Maj 2017.</p> <p><u>Plani:</u> deri në fund të vitit 2017, raporti i cilësisë për anketën TIK do të dërgohet në Eurostat nëntor 2017.</p> <p>Publikimi i rezultateve do të bëhet në janar 2018 dhe si e tillë do të vazhdojë si anketë e rregullt në ASK.</p>

5.4.1 Përpunimi i Statistikave të Veçanta

ASK-ja është angazhuar në përpunimin e Statistikave të Veçanta të Statistikave Zyrtare, në bazë të kërkesave të përdoruesve vendorë/ndërkombëtarë. Sa i përket grumbullimit të të dhënave, ASK-ja do ta bëjë vetë mbledhjen e të dhënave nga fushat e Llogarive Kombëtare (LLK), të Transmetimit të të dhënave për LLK sipas ESA 2010, të Paritetit të Fuqisë Blerëse, të Indeksit të Harmonizuar të Çmimeve të Konsumit, të Tregtisë së Jashtme, të Statistikave Afatshkurta të Biznesit, të Regjistrimit Statistikor të Bizneseve, të Statistikave të Turizmit, të Statistikave të Transportit, të Statistikave të Financave Qeveritare, të Procedurave të pabalancuara të treguesve makroekonomik (MIP, të TIK-ut, SILC-ut, AFP-se, të shpërndarjes, të mbështetjes ndaj përdoruesve nga Eurostati, të statistikave vjetore të kulturave bujqësore përfshirë kulturat shumëvjeçare të statistikave të prodhimtarisë blegtorale, Anketa strukturore e fermave, statistikave agromonetare dhe të mbeturinave.

Këto aktivitete nuk janë pjesë e Programit Kryesor të Statistikave Zyrtare. ASK-ja do t'i shfrytëzojë këto mundësi për t'i fuqizuar statistikat zyrtare me tregues dhe ngritje të kapaciteteve të mbështetur nga donatore të ndryshëm kryesisht Eurostat. Këto aktivitete zhvillohen në kuadër të periudhës kohore sipas marreveshjes në mes të ASK-së, Eurostatit dhe donatorëve tjerë.

Lansimi dhe financimi i këtyre projekteve nuk varet nga ASK-ja. Megjithatë ASK planifikon, organizon, zhvillon procesin e punës, në mënyrë të mirëfilltë brenda organizatës dhe t'i shtojë burimet shtesë kur është e nevojshme.

ASK-ja që nga fundi i vitit 2015 është në pritje të aprovimit të Udhëzimit Administrativ Nr.08/2012 (plotësim-ndryshim) nga Qeveria e Kosovës, që ofron bazë ligjore të realizimit të këtyre statistikave në përputhje me Ligjin ne fuqi.

6. PLANI I VEPRIMIT VJETOR 2018

6.1 Buxheti

Procesi i buxhetimit në kuadër të planit të përgjithshëm fillon me një konsultim të brendshëm në bazë të nevojave të departamentëve prodhuese në procesin e zbatimit të Planit Vjetor të Punës. Në këtë drejtim për vitin 2018, për t'i përmbushur detyrat dhe përgjegjësitë, e posaçërisht për t'i shtuar aktivitetet e tjera, Departamenti i Administratës merr informata nga të gjitha departamentët e ASK-së për qarkoren buxhetore të Planit Vjetor të Statistikave Zyrtare 2018, në mënyrë që të sigurohen të dhënat e mjaftueshme, lidhur me planifikimin e vitit vijues (2018). Sipas plotësimit të kërkesave të departamentëve të ASK-së, për përgatitjen e propozim-buxhetit, dokumenti duhet të përmbajë strategji afatshkurtra dhe afatmesme dhe një deklaratë mbi synimet dhe prioritetet, ku ASK-ja do të ketë një planifikim të mirëfilltë të buxhetit 2018.

Për aktivitetet e vitit 2018, me qëllim të realizimit të anketave, ASK-së i nevojitet rritje e buxhetit në kategorinë 'Mallra dhe Shërbime' (buxhet shtesë) prej 625, 000 Euro, për LLogaritë Kombëtare, Statistikat Ekonomike, Tregun e Punës, Statistikat e Varfërisë, Statistikat e Migracionit, Statistikat e Bujqësisë dhe Mjedisit dhe Statistikat e Ekonomisë Joformale. Në kategorinë 'Paga dhe Mëditje' nevojitet rritje të kapaciteteve njerëzore për 48 pozita të reja, për afërsisht me një kosto shtesë prej 264,614.00 EUR. Ndërsa, në kategorinë 'Shpenzime Kapitale' kërkohet buxhet për afërsisht 150,000.00 EUR për renovim të objektit .

Buxheti i ASK-së për vitin 2017 dhe planifikimi për vitin 2018:

Katëgoritë/ viti	2017	2018
Stafi	149	197
	Aktuale	Të nevojshme
Paga dhe Mëditje	920,177.00	1,189,391.88
Mallra dhe Shërbime	307,960.02	932,960.00
Shpenzime Kapitale	-	150,000.00
Shpenzime Komunale	21,875.000	21,875.00
Gjithsej	1,250,012.00	2,294,226.88

6.2 Pasqyra e prodhimit

Pasqyra përfshinë gjithsej rezultatet e prodhimit të ASK-së. Kjo i informon planifikuesit dhe aktërorët për frekuencën e publikimeve, partnerët e jashtëm, shpërndarjen e vëllimit të punës, kohën prodhuese dhe ditët e punës, si e hyrë në prodhim. Gjatë periudhës së zbatimit të programit të statistikave zyrtare pasqyra ka shfaqur një trend për zhvillimin e treguesve 4 dhe 5 të KVP-së në nivel produkti. Përfundimisht, plani pesëvjeçar ka vënë cakun për efikasitet në prodhim, me një reduktim në kohë për 20-25% deri më 2017.

I tërë procesi i zbatimit të programit 5 vjeçar të statistikave zyrtare është monitoruar në aspektin e zbatimit të objektivave të planifikuara dhe planeve vjetore me qëllim të mbarevajtjes së këtij programi dhe përmbushjes së objektivave të lartëcekura. Monitorimi dhe procesi i matjes së objektivave është zbatuar në tëresi dhe në bazë të kësaj rezullton se

disa nga objektivat janë tejkaluar nga parashikimi, e disa prej tyre janë realizuar ne nivel të kënaqshëm. Në zbatimin e rregullores për riorganizimin e ASK-së, procesin e monitorimit, aplikimit të standardve në prodhimin e statistikave zyrtare dhe në aplikimin e proceseve të tjera të bazuara në skemën e Ciklit të planifikimit. ASK-ja, gjatë periudhës 5 vjeqare ka shënuar progres të konsiderueshem krahasuar me periudhen fillestare të fillimit të zbatimit të programit të statistikave zyrtare (2012).

Synimi i ASK-së, është rritja e kapaciteteve njerëzore, profesionale dhe infrastrukturore me qëllim të shkurtimeve të kohës prodhuese në ofrimin e të dhënave statistikore tek shfrytëzuesit. Kjo është prezentuar në kolonën e fundit tek tabela pasqyra prodhuese. Pasqyra mbyllet me përmbledhjen në nivel institucional të ASK-së.

STATISTIKAT EKONOMIKE

Progr amet	Depart amenti	Prodhimet dhe shërbimet statistikore	Shpëshhtësia e publikimit	Koha e prodhimit 2014	Koha e prodhimit 2015-plan	Koha e prodhimit 2016-plan	Koha e prodhimit 2017-plan	Koha e prodhimit 2018-plan	BNJ(njerëz -ditë) 2015 plan	BNJ(njerë z-ditë) 2016 plan	BNJ(njerëz-ditë) 2017 plan	BNJ(njerë z-ditë) 2018 plan
PKSZ	DSELLK	Anketa Strukturore e Biznesit, ASB:4000 ndërmarrje	vjetore		343	341	339	338	118	124	276	265
PKSZ	DSELLK	IÇIMP (TM1-TM4,2017): 150 ndërmarrje	Trem.	324	304	282	272	264	89	242	242	234
PKSZ	DSELLK	Indeksi i Çmimeve të Prodhimit IÇP (TM1-TM4 2017): 150 ndërmarrje	Trem.	358	312	294	278	270	116	242	242	234
PKSZ	DSELLK	Stat. Afatshkurtra në Industri (TM1-TM4 2016): 200 ndërmarrje	Trem.	682	354	339	322	318	165	302	180	169
PKSZ	DSELLK	Stat. Afatshkurtra në Ndërtimtari (TM1-TM4 2017): 200 ndërmarrje	nuk ka	0	0	0	0	0	165	297	28	28
PKSZ	DSELLK	Stat. Afatshkurtra të Tregtisë me Pakicë (TM1-TM4 2017): 200 ndërmarrje		0	381	353		322	60	253	0	171
PKSZ	DSELLK	Repertori Statistikor mbi Ndërmarrjet në Kosovë	Trem.	165	144	128	125	121	38	84	16	16
PKSZ	DSELLK	Freskimi i Regjistrit Statistikor të Bizneseve, 6 000 ndërmarrje	nuk ka	0	0	0	0	0	78	69	166	148
PKSZ	DSELLK	Indeksi i Çmimeve të Konsumit	Mujore	167	159	146	140	139	157	275	286	281
PKSZ	DSELLK	Indeksi i Çmimeve të Konsumit	vjetore	176	170	160	157	152	47	45	48	46
PKSZ	DSELLK	Statistikat mbi Tregtinë e Jashtme	Mujore	410	359	344	300	287	98	235	245	237
PKSZ	DSELLK	Statistikat mbi Tregtinë e Jashtme	vjetore	175	170	161	159	156	48	43	19	17
PKSZ	DSELLK	BPV me qasje në shpenzime	vjetore	255	314	307	300	263	293	139	59	57
